

Kemi të bëjmë, pra, me dy projekte të mëdha, realizimi i të cilave është i lidhur me njëri-tjetrin: hartimi i një *Enciklopedie të letërsisë shqiptare* dhe rikonceptimi i vendosjes së letërsisë në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*. E them këtë, sepse mendoj se në sheullin XXI shkencën jonë duhet të synojë jo më botime të zakonshme, që, sado më pak, mund të reflektojnë përsëri disa nga dobësitë e deritanishme, por të hartojë **enciklopedi elitare**, në kuptimin më shkencor të strukturës dhe nivelit të paraqitjes së sistemit tonë letrar.

LETËRSIA JONË NË BOTIMET ENCIKLOPEDIKE: Çështje përzgjedhjeje apo metodologji e vlerësimit historiko-estetik? nga Floresha Dado



IN MEMORIAM

REXHEP FERRI,
poet i pikturës (fq. 17)

SKËNDER RUSI,
liriku korçar (fq. 2)

SHËNIME MBI LIBRAT

Ndjesi nga leximi i romanit "Provinca" i Liridon Mulajt

**TRISHTIMET E VJETRA TË
PËRTEJ PROVINCËS...**

Nga Lulzim Logu (fq. 7)

Nexhat Pustina, "Dallëndyshja e kujtesës"

**POETI QË SHIHTE NË DY
DRITARE**

Nga Emin Azemi (fq. 9)

Mbi novelat e Enver Kushit "Zonja nga Parga" dhe "Jonada"

NJERËZORJA NË DY NOVELA

Nga Odhise Çerkezi (fq. 12)

**SL LAVIZIMI "I BUTË"
I EMËRVENDEVE**

Nga Mehmet Elezi (fq. 10)

**DEA OPEN AIR
INTERNATIONAL
FILM FESTIVAL**

Në datat 9 deri më 13 qershor 2024, Festivali Ndërkombëtar i Filmit DEA OPEN AIR, do të zhvillojë edicionin e tij të njëmbëdhjetë në kryeqytet! (fq. 20)



ALI ALIU MES TRI SHTETEVE LETRARE

Nga Majlinda Rama

Në raste përvjetorësh, sidomos përvjetorë të tillë, përballë një shekulli pa pak, mendimi personal por edhe publik ndalet më tepër tek retrospektiva sesa tek perspektiva, për arsye që dihen. Dhe, në rastin e akademikut Ali Aliu, kemi të bëjmë me një kalendar jetësor, nga ata që dëshmojnë, jo vetëm virtyte individuale, por edhe një rrugëtim të gjatë që matet me peshën e veprave të tij. (Zakonisht, kjo është e vërteta e përballjes me vitet, që vjen një kohë, kur duhet të kthesh kokën pas dhe të shohësh, jo vitet, por gjurmën që lë dhe majën ku ngjitesh). (fq. 8)

Intervista në *Chicago Review of Books* për memuarin e autores Ani Gjika botuar në anglisht me titullin, "An Unruled Body".

ANI GJIKA:

**Zhdukja e zërit të
gruas nga kanoni
letrar shqiptar**
Suzana Vuljevic

Përktheu Granit Zela (fq. 22)



BIBLIOTEKË

Ismail Kadare (fq. 13)

Don Kishoti në Ballkan

Rexhep Ferri (fq. 16)

Ndoshta dashuri

Skënder Rusi (fq. 18)

Mos m'i merrni mbrëmjet

Vangjush Saro (fq. 11)

Duke pritur dekorimin

Susanna Kaysen (fq. 21)

Sekreti i Jetës

Përktheu: Miranda Enesi

Arben Mexsi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Dy shkrime mbi natyrën,
njeriun dhe vendin tonë në të
NGA CARL SAGAN DHE
STEVE MARABOLI

Përgatiti dhe përktheu: Xhensila Alla (fq. 23)

VEPRA E CARAVAGGIO-S
E ZBULUAR SË FUNDMI
VENDOSJET NË MADRID

Nga Rubert Plummer, BBC
Përktheu Andreas Dushi (fq. 21)

IN MEMORIAM SKËNDER RUSI

Me datë 31 maj 2024 ndërroi jetë në moshën 72 vjeçare liriku korçar Skënder Rusi duke përmbushur profecinë e titullit të një prej librave të tij *Dalëngadalë, unë po bëhem ikje*. Nëpërmjet këtij shkrimi, miqtë dhe bashkëpunëtorët e përkujtojnë kështu poetin e dashur.

Shtëpia botuese "Onufri" dhe gazeta "ExLibris" i shprehin ngushëllimet më të përzemërta familjes Rusi, veçanërisht zonjës Eglja dhe bashkëpunëtorit tonë Erisit, për humbjen e pazëvendësueshme të bashkëshortit dhe atit, poetit Skënder Rusi. Nëpërmjet këtij shkrimi, e kujtojnë miq të hershëm e të rinj, si njeriun që i dha letërsisë shqipe disa nga lirikat më të bukura.

Qielli i poetit Skënder Rusi, ka disa ditë që iku atje...

NGA VISAR ZHITI

Kur një poet shkon në qiell, pasurohet Qielli, - na vjen të themi, - dhe kur ai është mik, ti ndjen se krahërori të ngushtohet nga dhimbja e ikjes dhe i kthehesh poezisë së tij, që të qortosh ikjen, të vazhdosh ndërprerjen dhe kupton se tani ka filluar jeta e vërtetë e poezisë së tij, pra e poetit...

Gjëra të tilla kam menduar këto ditë, që nga fundi i majit, kur poeti i dashur Skënder Rusi zgjodhi të merrte rrugën e qiellit.

E di, ai shkonte herë pas here qiejve, merrte kaltërsi dhe dritë andej, re dhe shira dhe ylberë me poezinë e tij dhe, nëse këtë herë vendosi të mos kthehet, ndër librat e tij ai la copa jete, copa ëndrrash, udhëtime, mjafton t'i shfletojmë, aty do ta gjejmë, është më shumë se kudo, si në shtëpi, aq shpirtbukur...

Është një jetë e tërë që jemi miq, edhe pse bashkë kemi qënë shumë pak kohë, edhe larg, përveç viteve të studentit, kur u njohëm e rrinim çdo ditë, bisedonim, lexonim, shkruanim, shëtisnim, të dalldisur nga dashuritë...

Ishim me fat se na kapën fillimet e viteve '70, fjala është për shekullin e kaluar, që do të quheshin si "vitet e liberalizmit" dhe më pas regjimi do të dënonte ata që i damkosi si ideatorë të tyre viteve, shkrimtarë, dramaturgë, edhe aktorë cirku, muzikantë,

këngëtarë, piktorë, studentë, lexues, madje dhe librat vetë, jo vetem i ndalonin, por i riciklonte duke i kthyer prapë në letër në fabrikat që ndërtoan kinezët. etj.

Gjithsesi ne na doli e drejta e studimit atëhere, jo në Universitetin e Tiranës, por në Institutin e lartë të Shkodrës, ku mundën të shkonin dhe nga ata me "biografi jo të mirë" siç quheshin familjet e atyre që nuk i donte regjimi.

Dhe kështu pata fatin të njihesha me Skënder Rusin. E kujtoj ashtu aq të çiltër, me sy të pastër dhe të vëmendshëm, flokët e drejtë dhe të zbërdhlytë mbi ballë, nga Korça jam, nga fshati Vishocicë, tha, emër i çuditshëm për studentët, kishte diçka eksituese, thoshim, edhe veshje, edhe... pra, Skënderi kishte arsye të ishte më eseniniani nga të gjithë ne. Secili nga brezi im e mendonte poetin rus e sovjetik, Esenin-ikonë si më shumë të vetin, disa për lirikat aq kumbuese të dashurisë, disa për trishtimin dhe zhgënjimet, disa për vetëvrastjen dhe poezinë e fundit e shkruar me gjak... dhe donim të shkruanim si ai. Më të partishmit zgjidhnin Majakovskin. E përkthyer në shqip ky ishte dhe si një debat: me Kadarenë

apo me Dritëronë. Po Fatos Arapi? Më i trishtuari. Ndërsa Lasgush Poradeci, liriku qiellor, komplotohej me heshtje, ai i përkiste kohës se mbretërisë, aq sa e dinin të vdekur, kur ai bënte të xhindosurit me atë kohë xhindësh socrealistë.

Që sa më tregoi poezitë e tij të para, Skënderi më shumë ua tregonte vajzave më duket, unë i pëlqeva shumë për ndjeshmërinë dhe kadencën, për metaforën me të thjeshtë, pa hermetizëm siç na pëlqente një pjese, Lorka psh, po edhe Eluari, etj, po i gjenim librat e tyre, fyteshin fshehurazi në shqip nga Prishtina, na jepnin pedagogët vetë në mirëbesim, më pas ktheu, po i gjenim dhe rusisht, Jevtushenkon e rrezikshëm apo Tomas Eliotin bibliotekë, etj, do të na pëlqente të shkruanim me atë figuracion, edhe të shpërdredhur për të fshehur brenga, ide, pakënaqësi, pa qëllim dhe me qëllim, na ndodhte që të shkruanim dhe bashkarisht në të njëjtën fletë, duke ia kaluar njëri-tjetrit, Skënder Rusi, shoku tjetër po aq i dashur, Simon Vrusho, dhe unë. Vonë, pasi ndërroi regjimi, Skënderi do të fuste ndonjë gjë të tillë, kapriço me emrat tanë, në ndonjë një përmbledhjet me poezi të tij. Ndërkaq vetëm poeti Agim Spahiu, shok i ngushtë yni, arriti të botojë libër që student.

Kujtoj që profesor Hasan Leka na dha fshehurazi Skënderit dhe mua një libër me tanka japoneze, të poetit Isikava Takubok, që kishte jetuar sa Migjeni ynë, 27 vjeç dhe nga turberkulozi kishte ikur dhe ai. E përkthym bashkë të gjithin nga rusishtja. Kur më arrestuan, ma përmendin dhe në akt-akuzë atë emër, "raketakja" - i thoshte prokurori, - c'të duhej ai ty, armik!, - bërtiste, ne jse erdhi dita që fletoret tona, që mundën të shpëtojnë, së voni, pas rënies së perandorisë komuniste, t'i botonim dhe si libra më vete.

Skënderin, mbas diplomimit, e çuan mësues fshatrave afër vendlindjes, arriti të botojë, po krijonte emër në lirikën e re, unë nuk do ta takoja dot më, ndarja u bë dramatike dhe e gjatë. Në në burg unë kërkova të shihja shtypin letrat, aq sa mundej, doja të gjeja dhe emra shokësh, pra ishin dhe më ikte ankthi, kur lexoja poezi të tyre të botuara, e kuptoja censurimin, por gëzohesha që s'u kishte ndodhur gjë...

Malli për Skënderit do të ishte i gjithmontë. më vonë, do të merrja vesh se si do të specializohej në dramaturgji, për bibliotekat deri dhe kairo në Egjipt dhe do të ishte libretist në teatër, drejtor i bibliotekës së Korçës, qytetit të tij, siç do ta quante nëpër lirika, që do i kushtonte dhe një libër të veçantë dhe nuk do ta braktiste kurrë, as në kohët e ikjeve të mëdha.



I shkova atje ta takoj, në postdiktaturë, thoshim ne, s'kishte më Realizëm Socialist, por mbetjet ishin po aq të liga. Skënderi do të punonte me gazetën e parë demokratike të qyteti, edhe atë letrare, do të organizonte festivalin ndërkombëtar të poezisë "Netët Korçare", do të më ftonte dhe mua të mbillja një pemë në kopshtin e festivalit, etj.

Do të njihesha me Zonjën e tij, fëmijët, me shumë gëzim fliste për djalin që studioje në Universitetin e Romës, në "La Sapienza" dhe shkruante tregime. Do të më jepte të gjithë librat e tij me autograph, ishin bërë shumë, mbi 20. Gjithsesi Skënderi ishte vetëm poet. Dhe mua më mrekullonte, jo pa habi, që ai nuk ndryshoi fare deri në fund, po ajo poezi si tek të parat, po aq rinore, do të thosha, një permanencë sinqeriteti deri në mallëngjim, natyrisht që rafinohej, zgjeronte gamën e shqetësimeve, bashkë me entuziazmin dhe trishtimet, befasitë dhe zhgënjimet, por përherë i dashuruar...

Skënderi ishte lirik dhe poet i lirisë së brendshme, i dashurisë me sfond peizazhet, e pati të vështirë sigurisht si të gjithë, përveç të partishmëve dhe të patalentuarve. Herë here më dukej se donte të ishte ende si Esenini rural, por dhe si Jevtushenko - kyeqytetasi moskovit, por e kishte më të lehtë të bënte si Dritëroi devolli, korçar ishte dhe Koçi Petriti, që Skënderi i donte lirikat e tij,

Skënder Rusi i njohu mirë këta, poezitë e tyre, dukej sikur në atë rrugë po ecte, por më vete, i dalluar, i ngarkuar me barren e jetës së tij. Do të shkëlqente si yll i mbramë i lirikës korçare dhe jo vetëm, poet i Shqipërisë, aq i çiltër, me muzikë erërash, sy lulesh e flatime orësh, - kështu kisha shkruar me mall për poezinë e tij, - por ai ka rëndësi se ruajti të bukurën jetësore si ndjesi, si formë, si fjalë.

Edhe vdekjes po i këndonte bukur...

Gjithë këto ditë kam menduar i dëshpëruar për ikjen e tij. Po doja ta shikoja dhe si shpëtim. Ajo e dridhura e tij prej parkinsonit, e dija që shkaqet janë neurodegenerative, por i shikoja dhe si metaforë te ai, ndikim nga shqetësimet dhe faktorët mjedisorë, fërgëllonte koha në trupin e poetit...

Ndërkaq, teksa isha duke përgatitur diçka për në fb, pa m'i kërkuar kush, ca fjalë të thjeshta për Walt Witman-in në 205 vjetorin e lindjes së tij, poet që na rriti... mua, brezin tim, desha të them, kur lexoj, - shkruante i biri i Skënderit, Erisi, - që po atë ditë, në 31 maj, babai i tij, poeti dhe miku ynë, Skënderi, iku papritur në Qiell...

Ah, kishte zgjedhur të njëjtën ditë. Do jenë takuar patjetër shpirtat e tyre mes reve sonte... - mendova për humbshëm. Dhe u kujtova që librin e famshëm, "Fije bari" në shqip të Whitman-it e donim aq shumë, po që dhe libri i parë me poezi i Skënderit kishte bar në titull, "I njomë ishte bari".

Dhe kur? Kur dhe Whitman-i si poet amerikan, "këngëtar i demokracisë", ishte i ndaluar, aq më tepër që e kishte përkthyer një Skënder tjetër, luftër i Spanjës, rebel, megjithatë atë libër për fatin tonë të mirë, e kishte shpëtuat titulli, "Fije bari", e dinin libër agrokulturor, të paktën në Lushnjën time bujqësore, në vitrinën e librarisë ishte mes librave për grurin, si të rritim misrin, derrat, pambuku, etj, "Fije bari".

Po libri hollak i Skënderit, kur çdo gjë atëhere botohej me heqje e cungime si kositje e vrazhdë bari, me shtesa politike si me arna thesi?

I them këto për të kujtuar dhe kutuar kohën, si na bëri dhe si e bëmë, ku Skënderi ia doli dhe sfidoi, njerëzor dhe shpirtbukur, bisedat me atë mund t'i vazhdojnë të gjithë ata e duan dhe ai i donte, jo vetëm me librat e tij, por dhe me të birin-shkrimtar, Eris Skënder Rusi dhe kjo mbetet ëndrra më e shtrenjtë e tij...

Shoh qiellin tani i mallëngjyer, shoh fytyrën e lirikut tim...



Tim eti, dy fjalë

Nga Eris Rusi

Libri i fundit i babait tim, Skënder Rusit, titullohet “Dalëngadalë unë po bëhem ikje”. E zgjodhi vetë këtë titull, “Është poetik”, më thoshte, e kështu mbeti, deri në botim. Por poetët e dine kur është momenti të thonë gjëra që për njerëzit e zakonshëm janë ende të padeshifruara. Ditën e fundit të majit, 2024, siç kishte qejf ta quante babai im, bota e ndali rrotullimin e saj të zakonshëm për të. Poeti mbylli sytë e në buzë mbajti një buzëqeshje të padeshifrueshme, të qetë, të paqtë, sikur gjithçka e kishte një shpjegim, e qielli ja ku është, na pret të gjithëve. Një javë më vonë, në shtëpi ka një qetësi që të bën të rrih zgjuar. Të shohësh në errësirë, të dallosh dritën e dobët të hënës, që rrëshqet, e zbehtë, e tretur, mbi kopertinat e librave në bibliotekë.

Shtëpia e babait është e gjitha kështu: rafte librash, mobilje që mbajnë mbi vete tituj dhe botë të krijuara nga njerëz që kanë jetuar që nga fillimi i kohërave. Një pjesë të autorëve që kanë shkruar këta libra i kam njohur që në vogëlinë time. Dritëro Agollin, Moikom Zeqon, Petrit Rukën, Petraq Zoton, Demir Gjergjin, Simon Vrushon, Klito Fundon, Ylber Merdanin, Ali Bregun e sa e sa njerëz që dikur kanë ledhatuar flokët e mi të pabindur, më kanë përkëdhelur faqet feminare, ashtu siç ledhatova e preka unë flokët e tim eti, fytyrën e tij në gjumin e thellë.

Pastaj janë librat e njerëzve që s'i kam njohur kurrë, por ishin emra që i maj përherë brenda vetes, si krijues i kanë dhënë kuptim jetës sime, që i kanë dhënë formë mendimit dhe mënyrës si mund të marrësh frymë në një botë që s'është asnjëherë si duket.

Më tej, janë librat e babait tim. Të radhitur, gjithandej. Kishte shumë qejf kur shkoja ta takoja në shtëpi, gjëja që bënte të parën, ishte të vraponte drejt bibliotekës, të merrte një nga librat e tij e të niste të më lexonte. Por edhe kur krijonte një poezi të re dhe e printonte në disa kopje njëherësh. Çdo anëtar i të familjes i jepte nga një kopje, nuk pranonte që fleta të kalonte nga një

dorë në tjetrën. E donte përshtypjen menjëherë, njëkohësisht. Dëgjonte, e lumturohej.

Të lumtur, babain tim, me një hije të pandashme prej vetes, me emrin Parkinson, që u shfaq 27 vite më parë dhe u shndërrua në shtjellën që gllabëronte çdo moment të bukur të tijin, e kam parë vetëm pranë poezisë dhe nënës sime.

Në shtëpinë tonë, në jetën tonë, në qytetin e Korçës, kudo ku takohej me njerëz, babai dhe nëna ime ishin një. Nuk e kuptoj dot, si ka mundësi që fati i njerëzve të lidhet aq fort, nga ajo që babai im e ka quajtur esencë të poezisë së tij: Dashuria. Një dashuri e pakufi, që sonte, me këtë dritë të verdhë hënë që lëpin në heshtjen e padurueshme të natës librat e renditur në rafte, më ngjan se e mbajti në jetë për gjithë këtë kohë tim atë dhe poezinë e tij.

Unë po fle në vendin ku deri dje i jepej gjumit dhe ëndrrave poeti. Është shtëpia ime e fëmijërisë. Do të rri këtu sa të jetë nevoja. Dhe e ruaj ende brenda vetes ndjesinë e këtij vendi që të ngjan i njohur së jashtmi e ti guxon e futesh, pa qenë i sigurt në duhet të trokasësh a jo, në ka njeri brenda a jo, në do gjesh dritë dhe ngrohtësi brenda a jo... E dikur doreza përkulej lehtë, dera shtyhej pa pengesë dhe e gjeje veten brenda, ku shihja dikë që më përngjante me kujtimin më të dashur të jetës, të cilit i buzëqeshja dhe ai ma kthente qeshjen.

Dikur, ama. Por që nga dita e fundit e majit të këtij viti, jo më. Kjo ka qenë bota e tij, E poetit Skënder Rusi, e unë gjendem në shtëpinë e babait tim, ku flinte dhe zgjohej njeriu. E ku tani do të flerë e do të zgjohet përgjithmonë poezia.

- O bab'! - më vjen të thërras. Por hëna e verdheme, në qiell, më shpërqendron, ka hedhur dritën mbi kopertinën e librit “Dalëngadalë unë po bëhem ikje”! E njoh me detaje përmbajtjen e këtij libri. Gjergji dhe

Eralda që më kërkonin të zgjidhja poezitë me babain, e im atë, që donte të nxitoja, sa më shpejt, libri të dilte sa më parë, të shpërndahej e të ribotohej përsëri. Në çdo poezi, më ngjan sikur im atë ka dashur të thotë diçka. Të tregojë që mishi dhe gjaku, janë asgjë pa shpirtin, pa atë esencë që do të mbetet e do të kthehet në qiell, edhe kur të mos jemi më. Akoma më tej, im atë zgjedh të thotë diçka me një tjetër poezi të tij: “Nuk dua të ik i zemëruar”. Dhe iku i qetë. Pa iu rënduar kujt. Me asnjë, në jetën e tij, që të mbante inat, apo të donte t'i bënte keq. Dhe qyteti i Korçës, miq, të afërm, lexues, erdhën dhe e nderuan me lule pa fund në homazhin solemn, një ditë pas vdekjes. Gjithçka ishte si e shkruar me dorë prej tij. Në fund, të gjithë rrotull autorit, me aktorët që recitonin poezi, me njerëzit që prekeshin dhe me zemrat që mbusheshin me frymë. E tillë është jeta. Di të emocionojë, nga artistët, edhe në vdekje.

Kishte atë mirësi në jetë, im atë, që e ka marrë me vete edhe në rrugëtimin e fundit të tij. E donte Korçën, njerëzit e këtij qyteti, lexuesit që mblidheshin e dëgjonin poezitë e tij. Shtëpia e babait tim ishte dhe do të mbetet poezia. Më kujtohet kur më tregonte botimin e librit të tij të parë, në vitin 1975, “I njomë ishte bari”, lirika. Kur mori vesh që më në fund, pas nëntë herë refuzimesh, libri i tij do të botohej, im atë shpërtheu në lot. E lotët ishin të mëdhenj, si kokrra breshëri, që binin mbi tavolinë. Binin lotë, breshër që bënin zhurmë. Qante poeti. Me ngashërimë.

Sot, gjysmë shekulli më vonë, qajnë lexuesit. Poeti bëri sërish një zgjidhje si të tijat. Vendosi të ikë, pa lajmëruar, pa mërzitur askënd. Me një buzëqeshje në buzë, I paqtë, I mirë, si askush tjetër!

“Bab'!”

Këto fjalë i thashë njëherë, shumë herë, kur e gjeta pa jetë, teksa i

ledhatoja flokët, në gjumin e thellë, në dhomën e ndenjes, ku pengohej e rrëzohej ndonjëherë. Nuk m'u përgjigj. E mua më erdhi në mend poezia e tij. Shpirti i tij. Që vinte, në këtë formë:

DO TË KEM IKUR

Kur të shohësh se nuk do të ketë
më
asnjë bli,
Përgjatë rrugës me hënë të fikur,
Kur të shohësh se nuk do të ketë
më

asnjë gur,
Nëpër kalldrëmet ku dikur jemi
rritur,

Kur të shohësh se nuk do të ketë
më


asnjë oborr,
Me fëmijë që sapa kanë lindur,
Kur të shohësh se nuk do ketë më
asnjë kitarë,
Që të shpërndajë nëpër sokaqe
tinguj,

Kur të shohësh që nuk do të ketë
më

asnjë dritare,
Që të rrijë e hapur duke pritur,
Kur të shohësh se nuk do ketë më
asnjë puthje të re
nga të gjitha puthjet që janë
shpikur,

Dije,që, atëhere,
Unë do të kem ikur!

Tashmë, me vullnet të Qiellit, si për çudi shtëpia e fundit e tim eti, në varrezat e qytetit të Korçës, është nën hijen e një bliri të madh, gjetheshumë. Edhe në rrugën me hënë të fikur, im atë do ta ketë përherë blirin e tij, që do të thotë se nuk ka ikur akoma, që do të thotë se nuk do të ikë kurrë, im atë, poeti, i kthyer në shpirt.



S'ka dyshim se sot më tepër se kurrë Snjeriu e ka kthyer fytyrën nga harresa, jo se i pëlqen atij posaçërisht, por sepse kjo është kthyer në modë. Qoftë kushdo ky njeri, edhe poet. Mirëpo disa prej poetëve nuk janë harruar asnjëherë dhe nuk mund të harrohen kurrë, sido që vetë harresa është një mrekulli e jetës. Nuk është harruar asnjë ditë, asnjë orë, asnjë çast edhe Skënder Rusi. Poezitë, lirikat e tij të mrekullueshme përveçse në libra gjezdisin gjithë botën edhe në facebook. E lexojnë dhe e duan të gjithë. E ai më vjen çdo çast pranë nga Korça e tij e bukur në Tiranë (ashtu sikundër shkoj edhe unë tek ai), me fletët e printuara në dorë dhe më lexon lirikat e mbrëmshme, ndonëse dora e zëri i dridhen ngapak. Të bën për vete Skënderi edhe me pamjen emocionuese të Sergej Eseninit, po edhe me inteligjencën e Pushkinit. Është poet i të gjithë emrave të mëdhenj, po mbi të gjitha bën përshtypje vetë emri i tij tingëllyes. Sigurisht mbiemri i tij s'ka të bëjë aspak me rusët. Me Devollin po, me baltën, me ujërat e kulluar, me barin, ma ajrin e xigluar. Por, sido që të jetë, është miku im i mirë, dhe mos harroni një lirik i jashtëzakonshëm, dhuratë nga gjenia poetike e shekujve.

Mund të ishte emëruar mësues në fshatrat e Devollit e të Korçës, mund ta gjeje edhe sot atje, por ai i flaku tej shkumësin, fletorkat e hartimeve, rregullat e drejtshkrimin dhe iu qas teatrit, duke mbetur bashkë me lirikat e tij përjetësisht. Më pas erdhi edhe një tjetër vend i shenjtë: biblioteka, një ngushëllim letrar, që i vlente jo vetëm atij, por të gjithëve. Dhe jo më kot u bë biblioteka më e pasur në Shqipëri, pas Bibliotekës Kombëtare. Dhe me të erdhën panaire libri dhe zuri rrënjë një projekt krejt i veçantë, idealist: Netët poetike të Korçës, që mbledh poetë nga Ballkani dhe Diaspora, poetë edhe nga shumë vende të tjera. Atëherë lirika u bë shpirt i tij, jeta e parë, e dytë, e tretë. Aty, me lirikat e tij të mahnitshme është çdo çast, herë troket si Migjen, herë me parqet e bukura të Korçës, herë me gjimnazistet e brydhëta dhe studentet që pëshpëritin lirikën e jetës së tyre, pastaj rri nën qershinë aq delikate e intime, që i troket te dritarja. Ngushëllimi i tij në ca çaste poetike të pazbërthyesme bëhet shpejt një mik, kushdoqoftë ai, (vetëm fjala mik i krijon asociacion të çuditshëm dhe e hedh menjëherë në vargun melodioz, duke pikuar pjalmin e mjalit të tij të pakrahasueshëm), aty janë në delir personazhet pa emër, bukuritë e thella dhe shpirtit e njomë, të cilët i mban mënd përmendësh dhe t'i reciton me zërin këngëzues. Lirizmi dhe emocioni i thjeshtë njerëzor i vargjeve të tij ecën krejt ndryshe nga rryma poetike përkrah, që vjen natyrshëm e me aromë malesh e pyjesh, dëbore të dendur duke ngacmuar fort edhe fantazinë e kujtdo që i mban nën jastëk a mbi tavolinë lirikat e tij.

Që student u lidh një trio e mrekullueshme poetike që vinte si satelit pranë një ylli poetik si Frederik Reshpja në Shkodër: Visar Zhiti, Skënder Rusi dhe Simon Vrusho, po edhe mjaft poetë të tjerë. U krijua qielli poetik i Institutit në Shkodër dhe yjet u përhapën në qiellin poetik të Shqipërisë. Mund ta dëgjoje që ato vite zërin e ngrohtë poetik të Skënder Rusit, mërmërimën e gurgullim të rimës, psherëtimat dhe ngasjet e ndryshme lirike që bëheshin puthje, vajza të bukura, zjarr i ardhangët, limaksje e qetë dhe elegancë e mrekullueshme si mjegullnajë thjesht poetike. Asgjë nuk dramatizohet në krijimin e tij, veç shijes së lartë e që të krijon mbresën e një nostalgjie të çuditshme, përjetimin e dikujt tjetër, po që bëhet patjetër jotja.

Hera-herës të krijohet përshtypja e përshkallëzimit poetik dhe e një figuracioni enigmatik, ndoshta një prozë realiste poetike plot gjetje të imta befasuese, që zbulohen me finesë të rrallë, situata plot brengë e mall, prova të qarta besnikërie, ulërime të befta dhe të mbushura me një inat shfarosës, të cilat shpesh përputhen

LIRIKAT E PAPËRSËRITSHME TË SKËNDER RUSIT

nga Xhevair Lleshi

edhe me shijet e mia. Pastaj malet. Deti. E panjohura. Njerëz të thjeshtë, të njohur, puthjet në dyert e apartamenteve, vajza të bukura korçare, djem që sjellin aromë tjetër nga jashtë, që pastaj shkojnë dhe vendosen diku mes vetes së tyre...


Ç'përshtypje të lë lirika e Skënder Rusit? Moderne? E thjeshtë? Ngacmuese? Diçka që të rrëmben? Aromë mali apo deti?... Dhe ja:

*Sot jam ai që s'dua të jem,
Përfytyroni një pyll me asnjë ketër!
Jua kisha harruar edhe emrat njerëzve,
Ose nuk më pëlqente t'iu thërrisja në emër!
Disa më duken tmerrësisht të vegjël,
Akoma më të vegjël më duken të mëdhenjtë!
Unë një herë bëhem dimër me ta,
Një herë vjeshtë!
Seç mban këtu brenda kjo kokëza ime,
Lumë që rrjedh e kërkon detin!
Sot ndjehem i vetëm, përtej çdo vetmie,
As dorën nuk e dhashë të ma prekin!
Është dita që unë i kam braktisur të gjithë,
Në këtë qytet me sharlatanë tepër!
Tani do të shkoj të gjej dashuritë,
Në atë pyll ku s'ka asnjë ketër!*

Mos i rëndon diçka që ende s'e dimë si mallkim? Çfarë mendon ky poet i brishtë



dhe s'arrija të kuptoj se si i burojnë vetvetiu vargjet dhe si shkruhen aq shpejt në tastierën poetike të laptopit të tij? A e mban veten ky njeri për poet të shquar, si mjaft të tjerë të njohur e të panjohur? A e di ai se është tejet i kërkuar nga lexuesi? Në bibliotekën e qytetit të tij a vijnë të rinj (djem e vajza) dhe para tij, të emocionuar i recitojnë lirikat e ëmbla? A i mbeten në duart e djersitura prej ankthit poetik a prej përdorimit të librave dhe të lirikave,



diçka mes ndrojtjes dhe hallit? A e lëndojnë atë fraza dashurie? A e trembin gjetjet befasuese poetike, figurat e mëdha e njëherit të thjeshta?... Nuk e di as vetë se si më burojnë dhjetëra e dhjetëra pyetje, duke i rrokëzuar së brendshmi lirikat e tij.

Vështrimi i tij mbeti kurdoherë i kthjellët. Sytë vazhdimisht të qeshur. Një njeri që shpesh herë harrohet dhe i ikën vetes, si të thuash arratisë nga vetja, dhe asnjëherë nuk e di përse. Shkruan ngadalë, me kërcime të krahut që ka lindur duke u dridhur (shkak për këtë dridhje të mallkuar janë lirikat!), si për ta sfiduar më fort veten, që gjithnjë kërkon të thotë vetëm të vërteta, gjërat që i njeh mirë, dhe shkruan veç për të tjerët që janë shumë të thjeshtë, punëtorë, mbresa të thella, pyje, dete, vesë, mjegull, dritë, net, joshje... Dhe vargjet e lirikave të tij burojnë ujë të kulluar, kristale, njësi me ndriçim kozmik, drurë të veçantë pylli, aroma pa fund, shpirtra të gjallë që flasin dhe këndojnë, aq pranë qiellit, aq të friuar në frymë, aq të dhënë pas pasionit. Lirika që nuk shtiren. Kjo është e rëndësishme për lirikën. Poeti gjen kështu edhe lexues, vajza që e dashurojnë tmerrësisht... Dhe, ndërkohë, ai asnjëherë nuk i ka punët mirë me veten dhe kjo natyrisht s'është gjë e këndshme. Unë jam poet, thotë duke belbëzuar. Kam ardhur në këtë botë ja, për këto vargje. I shkruaj pasi i kam thënë mijëra herë me vete. I këndo, duke u ngjitur melodi që më burojnë vetiu. E çuditshme? Eh, sigurisht, një herë e kam të lehtë, një herë tjetër shumë të vështirë. Xhef, unë udhëtoj në det të trazuar, poshtë kam ajsbergun tim. Edhe kur jam në Korçë udhëtoj në këtë det. Madje edhe kur fluturoj. Bëj kujdes? Jo, kurrë. Madje nuk arrij dot ta zotëroj as kujdesin vetë. As që e kam fshehur ndonjëherë poetin nga qenia ime. Shpirti i poetit është xhungël. Asgjë tjetër nuk më ka interesuar jashtë lirikës, asgjë tjetër nuk më ndez si ajo. Nuk udhëtoj nëpër pyje të tjerë, se ndjej poshtë ajsbergun tim lirik. Nuk më duan si poet? Punë e madhe. Mua më botojnë, më japin honorare, me mua psherëtimë, këndojnë, se unë nuk jam poet i erotikës, por i shpirtit dhe mbi të gjitha i shpirtit të gëzuar, i dashurisë, i gazit dhe i dalldisë, i frymëzimit të thellë dhe natyrisht edhe i mëkëmbjes shpirtërore, e cila ta them hapur më josh pa masë. Por këtë e provon ai që vjen i lënduar, ai që jeton edhe me elegjinë. Herë-herë më kujtohet im atë, dashuria e tij e pamasë (U futa në ëndrrën e tim eti), fshati, mali dhe kur ndodhem pranë tij më kujtohet gjithnjë ajo që bëri me mua Simon Vrusho: erdhi deri afër fshatit seç pa a seç ndjeu ai dhe hunda e tij e di dhe më tha të ktheheshim në Korçë. E pashë, më tha. Tani e di se ç'është! Po të kishte bërë si gjithë të tjerët, nuk do të më mbetej në mendje... Jam i trishtuar, thua? Si jo. Por trishtimin e mbym me lirikën time e jo me duart e mia. Ty po ta them hapur, po ama dukem i qetë, i gëzuar, apo jo? Ja, ty si të dukem?

Eh, Skënder! Më lodhe, më tremb kjo lodhje që më krijon. E dinë të gjithë se ti ke një grua të bukur, mësuese letërsie në Korçë, që nuk të ndahet, madje të sjell edhe te shtëpia botuese në Tiranë, që të kontrollon me mënd, që të do fort dhe të mban si ujë e pakët duke të shoqëruar me ato parandjenjat instinktive të gruas, sepse ti i ke dhuruar mijëra fjalë të bukura, magjinë e lirikës, ndoshta prandaj dhe ka frikë për ty. Në sytë e saj, cepave të vështrimit ngacmues, ku kalon butësisht krenaria, mollëzave të rrumbullakosura ku fshihet një mbresë ngacmuese dielli, buzëve që kuqëlojnë edhe pse pa të kuq, por që hedhin shtat dhimbshëm rrudha trishtuese që fshih një vuajtje të pazakontë. E di që duheni mrekullisht e marrëzisht dhe lundroni mbi një ajsberg, që me siguri thur plane të fshehta për t'ju goditur tinëzisht.

Por mos harroni se mbi këtë ajsberg lundrojmë të gjithë. Por ama gruaja e bukur e ka hallin se bashkë me ta lundron edhe lirika e pazakontë e poetit të saj të rrallë. Racë në zhdukje poezia dhe lirika, racë në zhdukje edhe poetët...

Ja, kjo gjendje flinte tek unë deri ditën që më solle lirikën e tua të fundit, ditën e fundit të shtatorit. Më mbeti mëndja deri sa të kthehesha nga Franca, për një kohë fatmirësisht jo fort të gjatë, që t'i shihja, t'i lexoja, t'i përjetoja thellë, duke bashkuar dy tronditje njëherësh: tënden dhe timen dhe ia arrita ditës që të mbetem pa gjumë bashkë me ty dhe të belbëzoja vargje të magjishëm pafundësisht. Poeti nuk fshihet dot nga buja, nuk i fshihet dot shpirtit të poezisë së tij, nuk i fshihet dot edhe gruas së dashuruar, e cila detyrohet sigurisht nga rrethanat aspak të lakmuara për t'i bërë atentat të përditshëm lirikave të tij, ashtu siç bën edhe poeti me bukurinë e saj dhe asnjëherë tenton të mos bjerë në sy, por që sigurisht duket prej së largu.

Sa herë ndodhemi vetëm, më thotë: Do ta pimë një gotë, Xhef? Kam raki mani të Boboshticës zjerë dy herë! I ka mbetur kjo puna e gotës ngaqë në socializëm poetët gjenin prehje te rakia. Pastaj poetët vinin te manat e Boboshticës pët t'u dehur dhe për të thurur vargje. Mirëpo binin si mizat në grackën e mjaltit. Dhe mbeteshin aty. Dhe Korça bashkë me Boboshticën mbeteshin gjithnjë pa lirikën e poetëve. Skënderi, teksa i them kështu qesh. Por s'mund ta harrojë këtë fakt dhe thur lirikën e duhur, ku nuk lë pas dore as plakat e as pleqtë, as puthjet gazmore dhe as trimëritë boshe të njerëzve të kënduar. Vetmia, mërzia, pikëllimi, pengesat. Sa i hijshëm bëhet kur dëgjon, flet fare pak, asnjëherë nuk shan, i fshihet me guxim brengat e tij dhe tallet plot gojën me sëmundjen. E di kush ma mposhti? – pyet. Lirika e fundit që sapo shkrova. Kam dy ditë që merrem me këtë lirikë dhe nesër besoj do ta hedh në letër. Një javë mjafton për një lirikë? Sa javë mund të jetojë një poet?...

Sikur t'i bënin film lirikën e Skënder Rusit? Ç'filma do të dilnin vallë? Ja, përfytyrojëni këtë lirikë si në një film:

*Do të më duhet të rri edhe ca,
(Kam ende për të thënë shumë gjëra)
Ndonjëherë koha është vetëm një çast,
Edhe të duash, s'i thua dot të tëra!
Ndonjëherë, koha jam vetë unë,
Që hapin, jo si të tjerët e hedh!
Ngado që shkoj ma bën me sy një rrugë,
Ku asnjëherë s'më ka pëlqyer të ec!
Do më duhet të rri edhe ca,
Ju thashë, s'i kam thënë ende të gjitha!
Vetëm atëherë kur nisim e flasim përçart,
Duhet pranuar ikja!...*

Vërtet mund të bëhet një film me poezinë time? Duket gjë fort e vështirë, sepse Xhevahir Spahiut do t'i qenë bërë mijëra filma! Pa le Dritëroiti! Por megjithatë tingëllon e bukur.

As që më shkon ndonjëherë mëndja te fataliteti i poetit. Ndërsa tek fati fatal i lirikës po. Se ajo ecën në binarë paralel me elegjinë. Dhe s'ka faj. Aty ka shumë dashuri, shpikje, shtesa, intimitet, dekor romantik... Pastaj këngët e bukura që thuren me lirikën dhe duket sikur i këndon Elvis Presli. Pastaj *Danubi blu*. Qeshje poetike, qeshje me një vajzë krahaqafë, askush nuk përmbahet dot gjëkund, as Skënder Rusi jo. Mbrëmje magjike në pyll në netët poetike korçare, duke kënduar, duke qeshur, duke u puthur e duke thithur gjer në themel pjalmën e mjaltit. Emocione të forta. Të qeshura të papërmbajtura. Jetë. Ja. Kjo është lirika e këtij njeriu që i përjeton krejt ndryshe e madje të përmbysura gjithë realitetet e kësaj bote. Po ku e gjen fuqinë vallë? Ku buron frymëzimi i tij? Ah, të kishim mundësi dhe t'i gjenim. Me siguri do të mrekulloheshim. Por hë për hë le të magjepsemi me lirikën e tij të papërsëritshme...



Lamtumirë, Skënder Rusi

NGA JORIDA TOLLKUÇI

Skënder Rusi, një emër që do të mbetet përjetësisht në historinë e letrave shqipe, i kushtoi jetën e tij vargjeve të dashurisë dhe bukurisë së jetës. Poezitë e tij, të ndërtuara me delikatesë dhe elegancë, ishin një manifest i ndjenjave më të thella njerëzore. Ai dinte të shprehë me fjalë të thjeshta atë që shumë prej nesh ndjenim, por nuk mund ta artikulonim dot. Me stilin e tij unik, Skënder Rusi arriti të krijojë një lidhje të veçantë me lexuesit, duke u bërë zëri i shpirtit të tyre.

Kontributi i Skënder Rusit në kulturën dhe letrat shqipe është i paçmueshëm. Ai është Një ndër themeluesit e Festivalit Ndërkombëtar të Autorëve "Netët Korçare të Poezisë". Festivali më jetëgjatë në Shqipëri. Si çdo vit Skënderi ishte atje, mes miqsh të çmuar poetë të cilët e donin dhe e respektonin.

Fituesi i çmimit "Kurora e Poezisë", z.Besnik Mustafaj ia dedikoi çmimin Skënder Rusit.

Ne nuk e dinim që ky festival do të ishte takimi i fundit me të.

Pas pesë ditësh ikona e letërsisë shkoj në amëshim.

Por, Skënder Rusi nuk ishte vetëm një poet i shkëlqyer. Për vite me radhë, ai shërbeu si drejtor i Bibliotekës Publike "Thimi Mitko".

Ai e ktheu bibliotekën në një vend ku çdo lexues, i ri apo i vjetër, gjeti një strehë të ngrohtë dhe inspiruese. Me përkushtimin dhe pasionin e tij, ai kontribuoi në zhvillimin e kulturës së leximit në qytetin tonë.

Librat dhe poezitë e tij, të cilat do të ruhen përjetësisht në raftet e bibliotekës, janë dëshmi e përgjeshmë e trashëgimisë së tij letrare. Ato do të vazhdojnë të inspirojnë brezat e ardhshëm, duke mbartur në vetvete frymën dhe shpirtin e një poeti të madh. Kujtimi i Skënder Rusit do të mbetet i gjallë përmes fjalëve të tij, që do të vazhdojnë të jetojnë dhe të flasin me një forcë të pashuar për të gjithë ata që do të kenë privilegjin t'i lexojnë.

Ndarja nga jeta e Skënder Rusit është një humbje e madhe për të gjithë ne, por kujtimi i tij do të vazhdojë të ndriçojë në zemrat tona, si një yll që nuk shuhet kurrë.

Lamtumirë, Skënder Rusi. Vargjet e tua do të mbeten përjetësisht në kujtesën tonë, duke ndriçuar rrugën e dashurisë dhe bukurisë për çdo zemër që do të njohë artin tënd.



Homazh për mikun dhe poetin Skënder Rusi

NGA BESNIK MUSTAJ

Me Skënder Rusin kam pasur një miqësi afro gjysëm shekullore, në themel të së cilës mëqysh në zanafillë është dashuria për letërsinë e posaçërisht për poezinë. Kemi filluar të botojmë në të njëjtën periudhë. Dhe vinim të dy nga periferitë gjeografike të vendit, ai nga Devolli, pra nga juglindja e unë nga Tropoja, që është verilindje. Ky fakt i origjinës më duket me dobi të mbahet parasysh kur është fjala për të kuptuar një miqësi, të cilën nuk e ushqente denduria e takimeve dhe as koha e kaluar bashkë. Me përjashtim të një periudhe rreth dy vjeçare në mes të viteve '80, kur Skënderi erdhi në Tiranë për të ndjekur një kurs për skenarist pranë Kinostudios, ne jemi parë rrallë, një ose dy herë në vit, kryesisht në Tiranë, por edhe në Korçë. Dekadën e mbrame, kur gjendja e tij shëndetësore erdhi duke u rënduar, dhe unë, për arsyt e mia, udhëtoja shumë më pak se dikur nëpër Shqipëri, jemi parë edhe më rrallë.

Por Skënderi kishte një magji të vetën në mënyrën si e jepte miqësinë. Pavarësisht sa kohë kishte rrjedhur qysh nga takimi i fundit, sapo gjendesha me të, më krijohesh menjëherë një rehati sikur kishim qenë bashkë të djeshmen. Pak njerëz kam njohur si Skënder Rusin me këtë virtut, në kohën tonë, kur vetë miqësia po bëhet pak e më pak emocion lidhës midis njerëzve.

Kështu ndodhi edhe herën e fundit që u pamë, fundjavën e 25 e 26 majit (2024). Isha i ftuar në festivalin "Netët korçare të poezisë". Ky festival, më jetëgjatë dhe më emërmiri në llojin e tij brenda Shqipërisë, është krijesë e Skënder Rusit dhe do të mbetet si monument domethënës i dashurisë së tij misionare për poezinë, asaj kombëtare më së pari dhe po asaj universale. Kështu, dashuria e tij për poezinë shkonte shumë përtej dashurisë së natyrshme të poetit për veprën e vet, çka nxirrte në pah tek ai një tjetër virtut të bukur e që ishte mungesa e egocentrizmit. Nuk ndodh shpesh kjo te poetët në përgjithësi, të cilët bien zakonisht në sy pikërisht për egocentrizmin. Do të kisha thënë me bindje se ky altruizëm i Skënder Rusit nuk buronte nga ndonjë shprehje mosbesimi apo nënvleftësimi ndaj poezisë së vet. Kurrsesi.

Skënder Rusi ka qenë qysh në fillim, para 50 vjetësh dhe mbeti deri në fund plotësisht i vetëdijshëm për vokacionin e tij dhe i është përkushtuar atij me përparësi, me besimin dhe me vullnetin se po ndërtonte ditë pas dite një opus të rrallë për nga koherenca e stilit në poezinë shqipe. Ai na ka lënë trashëgim 25 përmbledhje me poezi. Ky fakt është më tepër se bibliografik. Ai tregon se Skënder Rusi ka synuar parreshtur të shkojë te lexuesi dhe të marrë mirënjohjen e tij. Jo rastësisht, njëri nga librat e tij të fundit ka për titull "Edhe perënditë e duan lavdinë". Përkushtimi i tij shembullor për tridhjet vjet në fillim si drejtor i pallatit të kulturës në Korçë (1991 – 1996), mandej si drejtor i bibliotekës së këtij qyteti deri në vitin 2017, duke qenë edhe themelues dhe kryetar i Klubit të Shkrimtarëve "Bota e re", Korçë si dhe themelues e drejtues i festivalit të mirënjohur të poezisë, vetëm nxjerr në pah ekuilibrin e mrekullueshëm të mishëruar në personalitetin e tij njerëzor dhe artistik. Besoj se ky ekuilibër e bënte atë edhe individualisht mik aq të mirë.

Fundjavën e fundit të majit të sivjetëm ai erdhi edhe të shtunën, edhe të djelën aty, ku ishin mbledhur poetë nga Shqipëria, Kosova dhe shumë vende të Europës. Mbrëmjen e dytë, e që ishte edhe përmbyllja e festivalit, ai u detyrua të largohej pak para fundit. Kishte orën e marrjes së ilaçeve. Qëndruam bashkë në tryezë gjatë gjithë kohës. Nuk pashë asnjë shenjë që do të më shtynte drejt pandehmës se ky do të ishte takimi ynë i fundit për së gjalli. Nuk m'u duk më i rënduar se herën e mbrame kur ishim parë, një vit e ca shkuar. Më tha se vazhdonte të shkruante poezi dhe nxorri nga xhepi një të shkruar atë ditë apo të djeshmen, të shtypur në një letër të verdhë. Ai, madje, piu edhe disa gllënka nga gota me verë të bardhë, që na u shërbye. Por kishte sjellë për mua botimin e vet të fundit "Dalëngadalë po bëhem ikje", të cilin ma dhuroi me përkushtim të ngrohtë. Nuk pata sy për të parë ndonjë paralajmërim në këtë titull. Përveç të shoqes, me të ishte edhe mbesa e vogël, vajza e Erisit, një nuselalë e bukur, që i sillje rrotull gjyshit gjithë dashuri dhe na bëri disa fotografi të paharrueshme, njëherë nga të cilat po e botoj me këtë rast.

Çmimin e madh "Kurora e poezisë", me të cilin u nderova, unë ia kushtova Skënder Rusit. Ai nuk ishte më aty për të më dëgjuar. Por, publiku korçar dashamirës i poezisë e duartrokiti nxehtësisht fjalën time, duke më treguar se, në të vërtetë, Skënder Rusi e kishte pushtuar tashmë zemrën e tij. Ky është shpërblimi më sipëror për një poet.

Pusho në paqe, i shtrenjti Skënder!

Duke u mbështetur vetëm në tre vepra: "Fjalori Enciklopedik Shqiptar", A.SH. RPSSH, Tiranë 1985; "Historia e Letërsisë Botërore", Rilindja, Prishtinë 1985, Vëllimi 2; dhe "Fjalori Enciklopedik Shqiptar", Tiranë 2008 (botim i ripunuar), mendoj se problematika e pasqyrimin të letërsisë në botime enciklopedike, përqendrohet në **dy boshte themelore** : në **aspektet praktike**, që kanë të bëjnë me vërejtjet mbi :

- përzgjedhjen e autorëve dhe dukurive letrare;

- me saktësinë e përcaktimit të llojit të zërit (të madh, të mesëm apo të vogël) për autorët e ripërfshirë, ose të futur rishtazi;

- me korrigjimin e raporteve jo të drejta midis autorëve;

- me krijimin e zërave të rinj apo heqjen e ndonjë zëri të panevojshëm;

- me shmangjen e subjektivizmit në përzgjedhje dhe në vlerësim;

- me korrigjimin e faktit që jo rrallë hartuesit e zërave nuk janë specialisët të mirëfilltë mbi autorin apo dukurinë letrare;

- me plotësimin e zërave të konceptuar varfërisht, ose çeshtjeve të pastabilizuara në interpretimin shkencor (si letërsia. arbëreshe);

- mbi nevojën e ndryshimit apo plotësimit të hierarkisë së vlerave, si pasojë e zbulimit të dorëshkrimeve të veprave të reja, etj.

Probleme të kësaj natyre, por edhe të tjera, ka shumë. Në botimet e 1985-ës janë në përmasa alarmante. Por, vizioni i sotëm i shkencës sonë letrare, nuk mund të mbetet thjesht dhe vetëm në konstatimet e problematikës komplekse, për të cilat jemi të gjithë dakort. Prandaj them se boshti i dytë, themelori në shkencën e sotme, ka të bëjë me **metodologjinë e konceptimit të pasqyrimin të letërsisë në këto lloj botimesh**. Duke patur parasysh këtë lloj botimi, **fjalor i përgjithshëm kombëtar**, ku dukuria letrare vendoset sipas vlerësimit historiko-estetik, çeshtja kapërshen thjesht kriterin e zgjedhjes dhe vlerësimit të saj dhe i përfshin pashmangshmërisht hartuesit në një varg diskutimesh të karakterit metodologjik.

Së pari, problem themelor është përcaktimi i **raportit informim / vlerësim estetik**. Në

një fjalor enciklopedik cili aspekt duhet të jetë në plan të parë: njohja e fenomenit, autorit, si fakt historiko-letrare, apo identifikimi i tablosë së specifikave artistike? Ka zëra të mëdhenj ku mbizotëron analiza, prej specialisti, mbi tiparet stilore-poetike, në dallim nga disa zëra, përsëri të mëdhenj, që konceptohen më shumë si informacion për një dukuri letrare.

Së dyti : prezantimi i letërsisë në botimet enciklopedike nxjerr problemin e **unifikimit të konceptimit strukturor** të zërave. Përgjithësisht, pjesa e parë, (jeta, formimi dhe aktiviteti jashtëletrar, etj.), është e strukturuar sipas të njëjtit parim; problemet lindin kur vjen momenti i prezantimit të krijimtarisë letrare. Diskontinuiteti në strukturën e

LETËRSIA JONË NË BOTIMET ENCIKLOPEDIKE: ÇESHTJE PËRZGJEDHJEJE APO METODOLOGJI E VLERËSIMIT HISTORIKO-ESTETIK?

nga Floresha Dado



brendshme të disa zërave na ve para çeshtjes : a duhet një strukturë e unifikuar, apo ajo mund të jetë edhe e variueshme, sipas specifikave të autorëve të ndryshëm ?

Së treti : Sipas cilit kriter duhet konceptuar një zëri *mesëm* apo i *vogël*? (sepse zëri i madh është më i lehtë.). Domethënë : cila duhet të jetë **dominanca përcaktuese** : prezantimi si krijues i mirëfilltë, apo si personalitet me kontribut në jetën politike-kulturore (pa mohuar vlerësimin e të dyjave)? Kjo lidhet edhe me çeshtjen se a do të mbizotërojë, në **llojin e zërit**, kriteri i sasisë së krijimtarisë, apo pesha e dukurisë letrare (edhe nëse kjo krijimtari është e pakët)? Në këtë aspekt, mendoj se kufiri midis zërit të mesëm dhe të vogël është më problematiku.

Së katërti : zërat përgjithësisht të mëdhenj, që merren me fenomene të periudhave, drejtimeve letrare, a duhen karakterizuar (sado pak) edhe në **plan krahasimtar** me letërsinë fqinje, ballkanike dhe më gjerë evropiane, kur dihet se pjesa më e madhe e krijuesve të traditës letrare zhvilluan aktivitetin e tyre krijues ose

në vende të tjera, ose nën ndikimin e autorëve evropianë ? Nga ana tjetër, për autorë që shënojnë hope cilësore në zhvillimin letrar, a mund të shtrihet ky parim krahasimtar, sado shkurt, edhe me autorë paraardhës dhe bashkëkohorë shqiptarë, sigurisht pa tejkalar caqet e një fjalori enciklopedik?

Së pesti: problematika metodologjike shfaqet edhe në **respektimin e specifikës** së një fenomeni përgjithësues, p.sh romantizmi shqiptar, apo tipologjia e gjinive letrare, në raport me dukuri që i përkasin një nënloji letrar, apo patosi të krijimit (siç ka ndodhur me zërin "letërsia satirike"). Një konfuzion i tillë shpreh mosrespektimin e kufijve të strukturës emocionale-tipologjike në kategorinë e gjinive, llojeve dhe nënlojeve letrare.

Së gjashti : botimi enciklopedik nxjerr edhe një çeshtje tjetër metodologjike: qartësinë e raportit midis qasjes ndaj fenomenit letrar si **historian i letërsisë, apo si kritik letrar**. Nëse themi: të dyja, vështirësia vjen, megjithatë, në kombinimin praktik, kur dihet se këto dy qasje kanë

specifikat e veta. Problemin e vërteton, p.sh., zëri mbi *Kritikën letrare*, me varfëri dhe pasaktësi të palejueshme. Saktësia e kësaj marrëdhënieje do t'i jepte përgjigje çeshtjes, që përmenda më parë, mbi kriterin e dominancës historiko-estetike, apo thjesht estetike? Nëse kritiku e interpreton veprën si **strukturë të realizuar**, si një konfiguracion të qëndrueshëm, ndërsa historiani e shikon strukturën poetike në **lëvizje konstante**, atëherë është e domosdoshme të kuptohet thelbi i këtij dallimi. Marrëdhënia midis sensit historik të kritikut dhe sensit kritik të historianit të letërsisë bëhet më të komplikuar në një botim enciklopedik. Mosvlerëimi i thelbit të dallimit midis kritikës letrare dhe historisë së letërsisë, ka sjellë shpesh kritere vetiake në hartimin e zërave dhe sidomos përzierje kriteresh në interpretimin e autorëve dhe veprave letrare.

Së shtati : Si mund të realizohet marrëdhënia e brendshme midis makrosistemit (letërsia shqiptare) dhe mikrosistemit (vepra, dukuria letrare)? Ndonëse zërat janë të shpërndarë, a është e domosdoshme të ndjehet filli i lidhjes midis tyre ? Ky parim i brendshëm, që sigurisht kërkon mjeshtëri në realizimin e plotë, shkencërisht ndihmon njohjen e hierarkisë së vërtetë artistike.

Së teti : Problem shumë i rëndësishëm është vemendja ndaj respektimit të kufijve të letërsisë, kur dihet se në tekste të ndryshëm janë konsideruar vepra letrare edhe të tilla që realisht qëndrojnë jashtë sistemit letrar. Në një fjalor enciklopedik, ku përfshihen monumente të kulturës së gjithë shekujve (15, 16), është e nevojshme të diferencohet lloji i tyre dhe prezantimi *si letërsi* të rrespektojë tiparin thelbësor të saj, si art i fjalës.

* * *

Pasqyrimi i strukturës së plotë të letërsisë sonë, në një botim enciklopedik, mund të realizohet vetëm në një *Enciklopedi të Letërsisë Shqiptare*. Padyshim, është koha të mendohet për një projekt të tillë madhor, i cili, gjithashtu, na përball me kompleksitet problemesh, sa të karakterit metodologjik, aq edhe të aftësisë së realizimit praktik.

Megjithatë, kam bindjen e plotë se realizimi i një enciklopedie të letërsisë shqiptare nuk mund të jetë i suksesshëm pa një histori të re, të rikonceptuar, të letërsisë. Dhe, nëse sot ne konstatojmë një varg problemesh në botimet enciklopedike ato, në thelb, reflektojnë dobësitë e *Historisë së Letërsisë*, e cila ka nxjerrë probleme metodologjike të sistemit të gjithë procesit historiko-letrar. Problemi nuk është thjesht korrigjimi në përfshirjen e autorëve, vendosja e raportit të drejtë midis letërsisë dhe realitetit historik, apo midis qasjes historiko-kontekstuale dhe qasjes sipas strukturave të brendshme

poetike, etj., por janë disa çeshtje themelore, që shënojnë realizimin e një shkence të vërtetë. Metodologjia ndërton marrëdhënien midis letërsisë dhe interpretuesit të saj. P.sh. është i rëndësishëm të kuptohet parimi se marrëdhëniet midis një modeli poetik dhe gjithë sistemit të letërsisë janë një nga kushtet për vazhdimësinë e të dyjave. Apo se evolucioni letrar sigurisht realizohet brenda sistemit, por njëkohësisht edhe në marrëdhëniet e letërsisë me sisteme të tjera : social, historik, ideologjik, etj. Apo njohja e faktit se teoria e formacionit estetik na orienton për ta parë një fazë të zhvillimit letrar sa në aspektin historik, aq edhe përmes tipologjizimit të formacioneve estetike. Dy aspektet e studimit të letërsisë sonë : i *gjenezës* dhe i *specifikës* së sistemit letrar, përbëjnë boshtet e konceptimit të historisë së letërsisë. Në trajtimet e deritanishme ka mbizotëruar prerja historiko-diakronike, por, në të vërtetë, dimensionin e *vështrimit diakronik* ka një përmasë më të gjerë se sa thjesht ndërtimi i një serie kronologjike veprash, të cilat kanë vlerën e paraqitjes historike të letërsisë sonë. Në kryqëzim me këtë rrafsh *prerja sinkronike* ndihmon që të zbulohen strukturat e reja letrare, që shpërthejnë letërsinë në një moment të caktuar. Por, nga ana tjetër dihet se sinkronizmi i pastër është tashmë një iluzion; çdo sistem përmban të kaluarën dhe të ardhmen e tij, që janë aspekte strukturorë të pandashëm. Nëse çdo sistem është një evolucion, ky evolucion ka, në mënyrë të pashmangshme, edhe një karakter sistemik.

Këto janë shumë, shumë pak, nga zgjidhja e çeshtjeve që do të realizonte një *Histori letërsie* me konceptime të reja, çka do të ndikonte drejtpërdrejt edhe në zgjidhjen e disa problemeve të botimeve enciklopedike. Vetëm mbi këtë bazë do të garantohej suksesi edhe i *Fjalorit Enciklopedik të Letërsisë Shqiptare*, kur dihet se një fjalor enciklopedik strukturohet në mënyrë sa të 'çuditshme', të 'ngatërruar', jashtë respektimit të rendit historik, etj. Renditja alfabetike, në një farë kuptimi, të fut në kurth, provokon zbehjen e vazhdimësisë logjike të dukurisë letrare, midis morisë së zërave nga fusha të ndryshme. Në daljen, me sukses, prej kësaj 'xhungle' mund të ndihmojë vetëm Historia e Letërsisë.

Kemi të bëjmë, pra, me dy projekte të mëdha, realizimi i të cilëve është i lidhur me njeri tjetrin : hartimi i një *Enciklopedie të Letërsisë Shqiptare* dhe rikonceptimi i vendosjes së letërsisë në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*. E them këtë, sepse mendoj se në shekullin XXI shkencën jonë duhet të synojë jo më botime të zakonshme, që, sado më pak, mund të reflektojnë përsëri disa nga dobësitë e deritanishme, por të hartojë *enciklopedi elitare*, në kuptimin më shkencor të strukturës dhe nivelit të paraqitjes së sistemit tonë letrar.

Ndjesi nga leximi i romanit "Provinca" i Liridon Mulajt

TRISHTIMET E VJETRA TË PËRTEJ PROVINCËS...

nga Lulzim Logu

Lexoj në një pasditje të gjatë, të një dite as dimër, as pranverë, kur dielli sadopak mundohet tu shpëtonte kurthit të reve të zeza, të cilat çast pas çasti lëshonin turra shiu të dendur, që të lëshonte pak rreze joshëse që ndillnin aromën e dheut gjysmë të lagësht. Kur të kujtohen papritur trishtimet e vjetra...

E kisha aty përballë në bibliotekë, skaj librit të fundit të Markezit, të dy më prisnin ti shfletoja menjëherë, por nuk e di përse isha stepur për të gjetur pikërisht një të tillë pasdite, një kohë kur ai këndi yt në dhomën tënde të ndënjes të duket aq ndjellës, ndërsa jashtë të neverit pejsazhi i papërcaktuar stinor dhe era e cila shkund polenin si pluhur trotuarëve...

Ballina e librit, me pamjen gri të antenave satelitore, të shumta në numër dhe gjithnjë duke u shtuar, përkundrejt zvogëlimit të numrit të bashkëqytetarëve të mi në qytetin tim të bukur, një mendim i tillë ngërthyer së bashku nga një moment shikimi në ballkonin tim të banesës, që sheh deri në prespektivë shetitoren kryesore të qytetit, më shtyu të marr menjëherë në duar librin e Liridon Mulajt "Provinca" e të shtyp për një kohë të dytë librin e dëshiruar prej sa kohësh të Markezit.

E lexoj me një frymë librin e Mulajt, duke kujtuar në çdo faqe sikur e kam lexuar disa herë, sikur po e rilexoj për të disatën herë këtë libër. Besoj se çdo lexues ndërsa kalon faqe prej faqe gjen patjetër diku veten e tij, ose së paku fragmente të rëndësishme nga periudha të ndryshme kohore, bëhet shpesh njësh me kuadrin kohor dhe shpirtëror të ngjarjeve të një jete e cila na kalon gati lakuriq para syve, ngjarje të një province, por që shfaqet si pjesë integrale edhe e mjedisve më të mëdha dhe të populluara të metropolit.

Provinca si nocion, si kufizim në hapësirë dhe kohë, si një mjedis i ngjeshur dhe i frikshëm i klisheve dhe dogmave jetësore, si vend vetvrasjeje dashurish dhe ndjenjash ,që u mirret fryma nga myku dhe kalbësira e mureve të saj të trasha dhe të trishita, por shpesh edhe si një lëndinë iluzionesh të bukura dhe të virgjëra, të cilat më pas në zhvillimin e tyre bien të rrënuara si qelqe të thyera trishtueshëm në ciklin e saj të çuditshëm...

Ky është ndoshta pohimi kryesor, i cili përmes episodesh të zakonshme njerëzore në dukje, por aq komplekse dhe një kaleidoskop i mrekullueshëm

personazhesh, ndjesish dhe ngjyrash të një epoke, e cila rezonon mezidukshëm, por gjithësesi ndihet, në tërësinë e vorbullës së ngjarjeve, ku autori është sa personazhi kryesor, poaq sa një kalimtar i ftohtë që vëzhgon nga larg kronikën e një epoke të pakallur, e cila nuk duhet harruar...

Mite dhe mure pa dyer...

Ka një stil të çuditshëm të shkruari autori, i cili jo rastësisht tani ka thyer pavëmendjen ndonjëherë trishtuese të opinionit të lexuesve të marrëmëndur prej librave limonadë.

Ngjarja dhe fryma e mesazhit që ngjit natyrshëm në përshkrimet e verteta, mbështetur nga kujtimet e ngulitura në kujtesën e tij tronditëse, përcjellja e mrekullueshme e trishtimeve të vjetra të përtej provincës deri në ditët dhe përjetimet tona të sotme, ndjenja se po jetohej dhe shkruhet njëkohësisht ngjarja dhe protestohet me frymën e shpirtit të pastër dhe fisnik të personazhit.

Këto dhe gjuha fine e romanit, pasuruar vazhdimisht me tone të bukura të figuracionit të veçantë e bëjnë librin një traktat dashurie, një kornizë e dëshiruar portretesh të shtrenjta të feminisë dhe jo vetëm, një kronologji pa skaje e ngjarjeve më përcaktuese të jetës së gjithësecilit prej nesh.

Një dritare që hapet kur duhet për të parë natyrshëm evolucionin tonë fizik dhe shpirtëror në raport me evolucionin gradual të sistemit social dhe të qëndrimit ndaj fazave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë së sotme, e cila njëfarsoj dikton sjelljet dhe personalitetin tonë.

Theqafjet e autorit në përpjekjen e ti për të ndjekur dhe për tu dhënë emër ëndrrave, ku Provinca si më e madhja ëndërr, shndërruar në një siluete delikate malli dhe nostalgjie, fije shprese e ndryshimit për të ardhmen mbetet kryefjala, rrjedh në shtratin e shtruar ëmbël me figurën lidhëse të ngjarjeve nanën, por edhe me portretet e dashura familjare dhe figurat fluide të dashnisë së hershme dhe të mëvonshme.

Ka sinqeritet rrëfimi prej një mjeshtri të fjalës, strukture solide në renditjen epokale të ngjarjeve, fantazi marrëmëndëse në qartësinë e marrëdhënive shpirtërore, krejt libri ngjan si një letër mallëngjimi shkruar thjesht për vetveten, e cila më pas në kohë ka fituar dhe është ngarkuar me plot mesazhe jetësore dhe të shpërthyer prej enës së shpirtit përballen me lexuesin e me furinë e ndjenjave të rralla për nga malli dhe lëngu jetësor që stërpikim në faqet e romanit dhe tingëllojnë në vetëdijen e lexuesit me akorde aq të bukura.

Kthimet tona...

Kalamendemi shpesh në kujtimet tona, sidomos kur kemi humbje shpirtërore, kur kemi mungesa, kur kemi mall të çmendur për të dashurit tanë të shtrenjtë. Kaplohet aty këtu feminia, dramati tona me prindër, të afërm dhe mentorët e dukurive të reja në kohë. Pavarësisht se ku jetojmë, në çfardo hapësire apo areali. Gjejmë provincën tonë të përkohshme të terrenit fizik apo shpirtëror, përpiqemi të zbulojmë ndikimin e saj në rritjen dhe afirmimin tonë, sikurse përcaktimin e fortë apo të dobët në fatin jetësor.

Gjithësesi janë kthimet tona të natyrshme në rrëjtë tona, filli që lidh të kaluarën me të sotmen, përpjekjet për ta kuptuar më mirë vetveten dhe qasjen ndaj trendit të botës në rrugajnë e saj të rrëmujshe. Një çast vlerësimi, por edhe një komunikim më i shpirtë me të tjerët pranë, për të ndërtuar vazhdimin tonë, me dashuritë dhe fëmijët...

Liridon Mulaj më kujton se rrëfimi dhe komunikimi me veten dhe të tjerët përmes kujtimeve dhe provincave tona , sinqerisht dhe pa frikën e pargjyqimeve na bën të ndihemi ndryshe, na bën të ndihemi më mirë. Siç u ndjeva dhe unë kur e mbarova me një frymë romanin interesant "Provinca"...



Jeta

Në raste përvjetorësh, sidomos përvjetorë të tillë, përballë një shekulli pa pak, mendimi personal por edhe publik ndalet më tepër tek retrospektiva sesa tek perspektiva, për arsye që dihen. Dhe, në rastin e akademikut Ali Aliu, kemi të bëjmë me një kalendar jetësor, nga ata që dëshmojnë, jo vetëm virtyte individuale, por edhe një rrugëtim të gjatë që matet me peshën e veprave të tij. (Zakonisht, kjo është e vërteta e përballjes me vitet, që vjen një kohë, kur duhet të kthesh kokën pas dhe të shohësh, jo vitet, por gjurmën që lë dhe majën ku ngjitesh). Dhe, në këtë kontekst, Ali Aliu ka lënë gjurmën e vet të dukshme me tërë veprimtarinë e tij shkencore, letrare, kulturore, por edhe qytetare dhe patriotike. Veçanërisht, ai mbetet modeli i intelektualit të përkushtuar dhe me kontribut të rëndësishëm në formësimin dhe zhvillimin e identitetit dhe kulturës shqiptare.

Ali Aliu u lind në një familje me kulturë dhe tradita në Prespë. Në fëmijëri, babai i lexon pjesë nga 'Qerbelaja' dhe 'Lulet e Verës' së Naimit, të cilat mund të kenë qenë shkëndijat e para që do ta ndikonin intelektualin e ardhshëm dhe do të formonin tek ai bazat e pasionit për gjuhën dhe dashurinë për kulturën shqiptare, për vendin dhe popullin e vetë. Me mungesën e dashurisë së nënës që e la jetim, (vetëm 5 muajsh), por dashurinë me familjarëve të tjerë dhe me sytë drejt majës së malit Pelister, rrëzë të cilit u lind, nisi rrugëtimin gazetari, kritiku letrar, profesori dhe akademiku i ardhshëm, i cili do të bënte bashkë, në një letërsi të madhe kombëtare, letërsitë e tri 'Shqipërive', siç i quante Ali Podrimja, apo trekëndëshit Shqipëri – Kosovë – Maqedoni e Veriut.

Jeta e Ali Aliut ndërlihet me ngjarje dhe zhvillime të kohës kur ka jetuar, ajo ballafaqohet me probleme thelbësore të karakterit kombëtar, politik, historik, të identitetit kombëtar dhe kulturor, me çaste heshitje dhe demonstratash, disfatash dhe ringritjesh të shqiptarëve. (Dhe në fakt, në këto rrethana, historia na ka treguar që intelektualët e mëdhenj e mbajnë peshën e rëndë të fatit të popullit të tyre, si edhe në rastin konkret. "Është portret i vendosur në kornizat e ngushta të një orvatjeje shekullore për mbijetesën e një populli, për mbrojtjen e një kulture dhe gjuhe të vjetër aq sa edhe vetë shkëmbinjtë e Ballkanit", përmend Kim Mehmeti në monografinë 'Kështu ecën njeriu').

Angazhimi patriotik u vu re qysh në vitet e studimeve në Beograd, kur ai dhe poeti Agim Gjakova, ndonëse fare të rinj, kaluan jo pak peripeci. Ata u përndoqën dhe burgosën për shkak të aktiviteteve të tyre propagandistike në mbrojtje të të lirisë së fjalës dhe të drejtave të shqiptarëve. Më vonë, pas studimeve, Ali Aliu filloi punë te "Flaka e Vëllazërimit", ku sërish do të vihej në krahë të shqiptarëve të nëpërkëmbur. Në vitin 1967, ai 'theu tabunë e heshitjes kronike' për padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve në Maqedoni. Me serinë e shkrimeve "Tetova parë nga afër", ai zgjoi shpresat në zemrat e shqiptarëve që mendonin njësoj dhe kërkonin të drejtat e mohuara. Këto shkrime u konsideruan si nxitëse të demonstratave të vitit 1968 në Tetovë. Siç vë në dukje, Fatmir Sulejmani, 'autoriteti i Ali Aliut në Maqedoni u rrit ndjeshëm pas publikimit të shkrimeve të tij kritike ndaj padrejtësive shoviniste maqedonase'. Duhet përmendur se, për shkak të zërit të tij të vazhdueshëm protestues, pushteti maqedonas ia hoqi nga qarkullimi të gjitha tekstet shkollorë, antologjitë e hartuara prej tij, por edhe veprat tjera studimore, duke i sekuestruar në të gjitha libraritë, programet shkollorë apo bibliotekat ku ato gjendeshin.

Pas përndjekjeve të shumta në Maqedoni, Aliu u vendos në Kosovë, ku vazhdoi të kontribuonte në jetën intelektuale, por edhe aty, do të zgjaste pak qetësia e punës si mendimtar dhe njeri i shkencës. Në kohën e shqetësimeve të mëdha politike

ALI ALIU MES TRI SHTETEVE LETRARE

Nga Majlinda Rama

dhe shoqërore, me nëpërkëmbjen brutale të të drejtave të shqiptarëve të Kosovës dhe represionin serb, sigurisht thirrja e parë shkonte që intelektualët të bëheshin bashkë. Aliu u rreshtua në krahë të studentëve që protestonin dhe të miqve dhe kolegëve të tij që padrejtësisht u përndoqën dhe arrestuan.

Pak vite më vonë, Ali Aliu bashkë me intelektualë të shquar të kohës, si Ibrahim Rugova, Jusuf Buxhovi, Fehmi Agani, Bujar Bukoshi, Mehmet Kraja dhe shumë figura të njohura shkrimtarësh e intelektualësh, u bënë nismëtarët e parë të proceseve të pluralizmit, duke themeluar të parin organizim politik në Kosovë, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK).

Më tej, Ali Aliu vijoi të ishte një ndër promovuesit kryesorë të kauzës së pavarësisë së Kosovës në diasporë. Ai ndërromori disa nisma që mbanin qëndrim ndaj diskriminimit dhe gjenocidit, si dhe lobi për çështjen kosovare në arenën ndërkombëtare, duke u marrë me organizimin e shqiptarëve në diasporë, një nismë që pati sukses dhe gjeti mbështetje të madhe. Në fillim të viteve 1990, me hapjen e zyrës së përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Tiranë, Ali Aliu u vendos në krye të saj, duke luajtur një rol kyç në promovimin e interesave të Kosovës.

Vepra

Në historinë e letërsisë shqiptare, figura e Ali Aliut qëndron në krye, si një ndër kritikët më të shquar me ndikim të lartë në jetën shoqërore e kulturore. Jetëshkrimi i tij shënon një udhëtim të gjatë dhe të pashkëputur të përkushtimit që pati dhe ka ndaj letrave, duke lënë një gjurmë të thella në identitetin kombëtar.

Me një karrierë mbi 60 vjeçare, në fushën e studimeve letrare, ka dëshmuar dhjetra vepra të rëndësishme. Njihet si hartues tekstesh shkollorë dhe universitare, librave në formën e leximeve alternative, paraqitje të përmbledhura të teorisë së letërsisë, monografi, antologji, artikuj studimorë, përmbledhje me studime, ese, kritika letrare etj.

Në tërë veprimtarinë e tij si kritik, Ali Aliu, shfaqet si një kritik që nuk kritikon, porse synon të zbulojë shtresat kuptimore

dhe bukuritë e veprës. Nuk kërkon skema dhe teori që të kanalizojë vlerësimin e tij mbi veprën dhe as humb kohën për të gjetur se cilës teori mbi kritikën do të zgjedhë. Kjo e ka çliruar nga formatet klasike të njohura të studimit të tekstit. Ai lexon dhe reflekton mbi leximin. Është lexuesi më i thellë i tekstit dhe më i kujdesshmi ndër ta.

Teoritë mbi kritikën letrare na sugjerojnë disa syresh të tilla, (nënllaje apo nënsisteme); kritika që lëvron Ali Aliu zë shtrat në kritikën impresioniste, të cilën Zhyl Lemetër e konsideron si kritikën më të vërtetë, pasi kriter themelor për vlerësimin e tekstit ka përshtypjen, impresionin, gjurmën që lë leximi, emocionin që mbetet. Këto përjetime dhe mbresa sigurisht që nuk mashtrojnë asnjëherë, madje, në rastin konkret me Aliun, kanë krijuar empati mes kritikut, krijuesit dhe lexuesit, duke ndërtuar një lidhje unifikuese të mrekullueshme të kësaj trioje, si një vatër policentrike që jep dhe merr valë komunikimi. Sepse Aliu nuk ngrre mure, por krijon ura mes tyre.

Është thellësisht reflektiv. Reakcionet e shpirtit gjatë leximit i përçon në mënyrë të përsosur tek lexuesi, sa që kur e lexon, (ndonëse libra voluminozë), nuk bëhet i lodhshëm, përkundrazi lexohet si një studim, si një ese, si një krijim estetik më vete, që ecën dhe të rrëmben. Pra, befas të fut në një hulli të re, dhe ndërton një botë mbi botën e parë, atë që lind nga teksti ku ai referohet.

Ndoshta pa e patur qëllim në vetvete, por duke e njohur mirë letërsinë, filozofinë, psikologjinë dhe fushat afër e rreth tyre, profesori duket se e mban me vete lupën shqyrtuese, duke hulumtuar në çështje filozofike (kritika filozofike) varësisht gjatë leximit të tekstit, të cilat mund t'i dalin gjatë rrugës, sikurse janë çështje të ekzistencës njerëzore, humbjes apo absurdit, gjetjen e kuptimit të jetës, etj.

Veçanërisht në studimin e poezisë, (që, padyshim është lexuesi më elitar i saj), fokusohet në estetikën dhe filozofikën, synon të zbulojë detajin e veçantë, mesazhin, etj. Pra, thënë me pak fjalë, veprimtaria studimore e Aliut shpalosë interpretime të thella mbi disa aspekte, të cilat përfundojnë si analiza të suksesshme, por edhe si lexime alternative për t'i dëshmuar lexuesit dritare të reja leximi e përjetimi, për ta ndihmuar



atë që ta mbërrijë thelbin e veprës, duke ia lehtësuar procesin e të kuptuarit, por edhe ta ndihmojë atë (sidomos studentët dhe studiuesit e rinj) të zhvillojë një sens kritik të mendimit dhe, në disa raste, kjo mënyrë e të bërit kritikë zgjat fije mbi çështje jo thjesht të ekzistencës, por edhe mbi botëkuptime metafizike, që shpesh na çojnë drejt dilemave dhe pikëpyetjeve mbi qenien, shpirtin dhe materien.

Alfred Uçi e quan Ali Aliun "Gjeneral" të mendimit kritik, dhe në fakt, kushdo që e njeh, e dëshmon se Ali Aliu, nuk ka vepruar si individ, por si një institucion i mëvetësishëm, që në laboratin e vet mbi gjysmëshekullor, ka marrë statusin e primarit. Falë dashurisë, përkushtimit, por edhe ndershmërisë me lexuesin dhe krijuesin, ai ka arritur të fitojë të drejtën si Certifikues Zyrtar i veprës letrare. Nuk njoh ndonjë rast, të ketë shkruar Ali Aliu për ndonjë shkrimtar të ri dhe të mos i jenë hapur dyert e universit. (Po citoj një ish-profesorin tim, i cili thoshte "Le të shkruajë edhe keq, mjafton që për veprën tënde të ulet dhe të shkruajë Ali Aliu").

Gjatë aktivitetit të tij mbi mendimin kritik, u ka dhënë hapësirë të rëndësishme autorëve të traditës, por kontributi më i madh shënohet në studimin e letërsisë bashkëkohore shqipe. Letërsinë e ka parë si një të tërë, mjafton që ajo të ketë qenë e shkruar në gjuhën shqipe, duke kapërcyer kufijtë gjeopolitikë. Ka studiuar vepra dhe autorë që i ka parë si përfaqësues të denjë të brezave letrarë, por edhe si një dëshmi e letërsisë së mirë kombëtare. Përmendim këtu, De Radën, Naim Frashërin, Fan Nolin, Faik Konicën, Lasgush Poradecin, Jakov Xoxën, Dritëro Agollin, Ismail Kadarenë, Fatos Arapin, Azem Shkrelin, Ali Podrimjen, Luan Starovën, Xhevahir Spahiun, Sabri Hamitin, Mehmet Krajën, Zija Çelën, Zejnullah Rrahmanin, Luljeta Lleshanakun, Flutura Açkën, Rita Petron, Mimoza Ahmetin, Lindita Ahmetin dhe, (me përulje e them, ndihem e privilegjuar që në kolanën me shtatë autorë bashkëkohorë, njëri libër monografik i profesorit është për krijimtarinë time, titulluar "Majlinda Rama dhe universaliteti i saj krijues").

Si dashamirës i letërsisë, me kureshtje i ka ndjekur nga afër zhvillimet letrare, ka lexuar me pasion mbi çdo gjeneratë, duke mbërritur deri te letërsia e re që po zhvillohet sot tek ne. (Ndryshe nga pjesa dërrmuese e kritikëve të institucioneve tona, studiuesve të punësuar, profesorëve të universiteteve apo edhe akademikëve, që e kanë, në një sens, obligim për ta vijuar ndihmën në krijimin e zinxhirit të brezave krijues, por, në fakt i injorjnë dhe distancohen prej tyre duke i paragjykuar, Ali Aliu është krejtësisht ana tjetër e medaljes. Ai e lexon letërsinë e re pa paragjyqime dhe është mbështetësi më i madh i të rinjve. Nuk lodhet kurrë t'i lexojë, me shpresën se mos bën zbulimin e radhës të talentit të ri, siç edhe ka ndodhur me rastin e shkrimtarëve të rinj, Andreas Dushi dhe Ervin Nezha... Madje, duhet thënë se profesori, shkrimtarët tek të cilët fokusohet, i ndjek në gjithë ecurinë e vet krijuese, nuk i braktis ata, duke u bërë një dritë e ndezur orientimi dhe mbështetjeje e vazhdueshme njëkohësisht.

Gjatë gjithë karrierës së tij, Ali Aliu rezonon ndikim në formimin e opinionit publik, në lidhje me vlerat letrare dhe kulturore. Kritikat pozitive që ai ka bërë,



kanë nxitur hapësira të reja mbi cilësinë dhe vlerën e letërsisë, kanë dhënë impakt të rëndësishëm në formimin e perceptimeve dhe qëndrimeve të shoqërisë sonë ndaj krijimtarisë letrare. Ka ndikuar në zhvillimin e kulturës dhe traditave letrare, në ruajtjen dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore, në krijimin e një kuptimi më të thellë dhe më të qartë të identitetit kulturor.

“Don Kishoti shqiptar”

“Don Kishoti shqiptar”, që botimet “Toena” e kanë sjellë të ribotuar me disa plotësime, dhe që nga profesor Shaban Sinani mësova që qenka libri më i përkthyer i profesorit, është një libër, veç të tjerash, origjinal, i një “ideje fatlume”, siç e quan Gane Todorovski. Bosht i të cilit janë studime depërtuese dhe analitike. Një mendje si e Aliut mund të kërkonte shtigje të tilla, të të gjeturit të elementit donkishotesk në një ambient të letërsisë shqiptare.

Titulli i librit, në pamje të parë sikur krijon një abstragim çoroditës, por në fakt, secili nga ne e ka, në mos një grimcë donkishotizmi brenda vetes. Kjo është lavdia e dorës së Servantesit, i cili pas betejës së Lepantos, me heshtjen letrare krijoi personazhin e të gjithëve, Don Kishotin, që vazhdon të bëjë xhiron e botës tejndanë, gjithmonë si një model referencial, me një dritë të re interpretative, krahasimi, kontrastuese, dystuese, gjykimi, vlerësimi a simbolike.

Është e thjeshtë dhe lehtësisht e skanueshme nga lexuesit e të gjitha shtresave: Don Kishoti udhëton muzave krijuese përmes filozofisë së tij, pra përmbajtjes dhe idealit, sepse, nëse do të ishte për jashtësinë shprehëse të tij, siç janë forma dhe zbrazëti, sigurisht që askush nuk do të merrej me të, e ca më pak kritiku i njohur Ali Aliu.

“Don Kishoti shqiptar” është një libër që paraqet një formë të re leximi dhe interpretimi, zbërthimi psikologjik, perceptimi mbi botën e mirë, por edhe si një kod që dinë ta çkodifikojnë vetëm të ngjashmit, vetëm ata, shpirtrat e të cilëve, kanë të njëjtën hapje ndaj botës, që kërkojnë harmoninë perfekte, që kanë të njëjtat dëshira për ta parë universin në paqe, njeriun më të mbushur, sidomos në kohë të tilla kur vlerat njerëzore po humbasin e zbehen çdo ditë.

Alonso Kishano alias Don Kishoti, ky kalorës i arratur, pluhurosor në jermi shekullor, mbërrin po kaq aktual në historinë e letërsive tona. Figura e Don Kishotit është bërë proverbiale, por kuptimi i tij nuk qëndron te një kalorës mendje-erë që humb kufijtë e kohës, por së brendshmi, në konceptin dhe përpjekjet e gjithëmundimshme të tij për një botë më të mirë. Ky është thelbi, në filozofinë e studimit të Ali Aliut, i cili e ka rrëmbyer këtë personazh dhe e ka sjellë në hapësirë e kontekst kohor gjithëshqiptar.

Aliu ka ditur të qëmtojë tekste, periudha dhe autorë, të cilëve u ka gjetur “Fijen e Arjanës”, të përbashkët të tyre, që i lidh në idealin donkishotesk. Ky këndvështrim, duket se mund të lindë vetëm nëse je edhe vetë një njeri me ideale e qëllimiri si Don Kishoti dhe, për mua, edhe vetë autori i tekstit është njëri ndër ta.

*Fjala e mbajtur në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me rastin e 90 – vjetorit të akademikut Ali Aliu.

Referenca:

Mehmeti, Kim. (2007). “Kështu ecën njeriu”.
Sulejmani, Fatmir. (2024). Citime nga shkrimet për akademkun Ali Aliu.
Podrimja, Ali. (2013). Vepra.
Aliu, Ali. (2024). “Don Kishoti shqiptar”, ribotim i plotësuar.
Aliu, Ali. (2019). “Kolana e autorëve bashkëkohorë”.
Arkiva Personale dhe Biblioteka Kombëtare për veprat e Ali Aliut.

POETI QË SHIHTE NË DY DRITARE

Nga Emin Azemi

Të gjithë studiuesit e tanishëm dhe të ardhshëm të letërsisë, sigurisht që emrin e poetit Nexhat Pustina do të duhej ta vendosin në kontekstin e një metodologjie më të avancuar të vlerësimit teoriko-kritik, duke i dhënë kështu kësaj poezie vendin e merituar në korpusin e përgjithshëm të hapësirës poetike shqiptare.

Qysh kur doli me librin e tij të parë me poezi “Zë bylbyli, lule maji”, në vitin 1969, pastaj me “Zëri në shtrëngatë” (1972), “M’i vjedhin gurët” (1977), e deri te libri i fundit “Këngët rebele” (1981), poeti Nexhat Pustina ndoqi një diagram cilësor në ngritjen e vlerave dhe formave shprehëse në poezi.

Ai është përfaqësuar me poezi në një përzgjedhje letrare me titull “Shkëndijat e para”, Prishtinë, (1956) dhe “E di një fjalë prej guri”, Tiranë, 1972, kurse poezinë e parë “Bujku” e kishte botuar në revistën letrare “Jeta e re” (3/1950).

Edhe pse jo sa duhet e përfshirë në procesin komunikues me lexuesin e sotëm dhe ende më pak e trajtuar meritueshëm nga mendimi teoriko-letrar, kjo poezi, megjithatë, e ndërtoi natyrshëm procedun e vet të ligjërimit lirik që bazohej kryesisht në dy burime: në poetikën tradicionale dhe në krijimtarinë gojore, duke riformësuar vargje me një intonacion të ri artistik.

Poezinë e Nexhat Pustinës e përshkruajnë kryesisht motivet që bashkëjetojnë me natyrën e njeriut të kohës së tij dhe kompleksitetin e gjallimit, duke filluar nga intima dhe bota refleksive e njeriut, dimensionin social i përditshmërisë dhe

notat melankolike nga e kaluara, deri te përshkrimi idilik i natyrës si dhe portretizimi i kategorive dhe moshave të ndryshme (plaku, romi, djaloshi, vasha, shoqet e nënës, vajza e moshuar, vajza e katundit, tezet e bekuara, shoqet e nënës, poeti rebel, pleqtë e rinj, vajzat mëkatore etj).

Përkushtimi i tij ndaj poezisë i ngjante një latuesi të kujdesshëm që sipërfaqen e lëmuar të subjektit lirik e ruante nga vrazhdësia e jetës, me një lirizëm të hollë, por edhe duke e përafëruar mimetikën kombëtare letrare me trendet moderne të poezisë, por pa e humbur vulën e origjinalitetit krijues, sepse, siç do të shprehet ai “shkrova një poezi autentike si shprehje e përjetimeve intime... motivet janë lirike, refleksive ... rrugën e vërtetë të poezisë moderne e ka gjetur vetëm ai poet i cili sheh në dy dritare - ku në njërin sheh të kaluarën edenj për respekt e në tjetrën hapat e kohës...” (“E dua poezinë time”, Flaka e Vëllazërimit, 29 prill, 1979).

Në kohën kur shkroi poezi Nexhat Pustina, letërsia shqipe e krahuat këndej Drinit, përfshihet edhe Murat Isakun, Abdylazis Islamin, Murteza Pezën, Adem Gajtananin, Xhabir Ahmetin, Resul Shabanin etj. kishte filluar të ushtrojë ndikimin

e saj në formimin kulturor të publikut. Kjo poezi komunikonte me kohën dhe motivet i merrte nga ajo kohë (vitet gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë), e cila ende në verbin poetik trajtohej metaforikisht, për shkak të rrethanave jashtë letrare të cilat i imponoheshin zhvillimit të letërsisë.

Në dioptrinë kritike të kohës, poeti Nexhat Pustina nuk ishte vlerësuar si dhe sa duhet. Megjithatë, prirjet e poezisë së tij, sidomos me drejtpërdrejtshmërinë e komunikimit me lexuesit si dhe me qartësinë e vrojtimit të gjërave, pa pasur nevojë për ekperimentime letrare, nuk mbetën pa u vërejtur nga disa autorë (Hasan Mekuli, Vehap Shita, Murat Isaku, Mensur Raifi, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, Nijazi Muhamedi, Hysni Hoxha, Xhemal Mustafa, Alush Kamberi, Qani Mehmedit etj.)

“Tërë poezia e Nexhat Pustinës, me rrafshin e vet ideo-artistik, brendinë, porosinë, fillet, është një “lutje”, ose, siç pohon edhe vet ai, një “apoteozë” e paqes, e urtisë, e mirëkuptimit midis njerëzve, kohëve, të ardhmes me të tashmen”, shkruante, në mes tjerash, shkrimtari Murat Isaku, në parathënien e librit të Nexhat Pustinës, “Poezi të zgjedhura” (1987).

Verbi poetik i Nexhat Pustinës nuk ishte i mveshur me shkëqim verbues të një simbolizmi të thatë, por ishte më tepër një dialogim me njeriun e thjeshtë, sepse brumi poetik i tij “gatuhej” në përmasat sa të gjera, aq edhe të thella të “magnitudës” emocionale e shpirtërore të heroit të tij lirik. Kjo thjeshtësi komunikimi shkonte përtej dhe madje ishte vërejtur edhe nga kritiku Ali D. Jasiqi (“Pesha e fjalës”, 1971), i cili konstatoonte se “poezia e Nexhat Pustinës nuk është e thjeshtë vetëm në formën e saj, por edhe në shtruarjen e çështjeve, në paraqitjen e përjetimeve poetike, që në të shumtën e rasteve mbesin vetëm përjetime personale të tij”.


Udhë që bën arti letrar, nuk është si çdo udhë tjetër. Ajo udhë karakterizohet me përjetime, shqetësime e ngazëllime nga më të ndryshmet të një autori, i cili në momente të caktuara, ndonëse i duket vetja i vogël, ia kthen shpinën erës që t’mos e shuaj dritën e kandilit në errësirat e denduar e kohës.

*Unë jam një kandil i vogël ndriçoj ngapak,
Filitin e kam në trup, pa kokë, drejt
Shpirti më rri i ndezur mu në flakë
As që shuhet, as që soset, në jetë e përjetë
(Kandili).*

Poezi Nexhat Pustina poezinë e tij mbështolli me një mision e shenjtë, që vetëm arti i mirëfillt mund ta ketë, duke e funksionalizuar këtë mision si mjet që porosinë poetike e ngrit në një rrafsh më të lartë të komunikimit, brenda hapësirës letrare që autori ngadal por sigurt po e pushtonte. Sepse, siç do të thoshte Nijazi Muhamedi “e vështruar për nga përmbajtja, poezia e Nexhat Pustinës posedon vlera, që jo vetëm që e dëshmojnë prezencën e tij në letërsi, por ia caktojnë edhe vendin në suazat e saja” (Nijazi Muhamedi, “Poezia dhe kontinuiteti”, Flaka e vëllazërimit”, 17 korrik, 1974).

Duke i bërë një “shëtitje” gjithë opusit poetik të Nexhat Pustinës, mund të themi se përzgjedhja që kemi bërë është vetëm një provë për të risjellë në një libër të vetëm ato vlera letrare të autorit që edhe për lexuesin e sotëm mund të jenë intriguese, të paktën në fushën e receptimit të një krijimtarie e cila sot edhe si stil, edhe si shprehje, megjithatë ka pësuar një riformatim estetik e poetik.

Të gjithë studiuesit e tanishëm dhe të ardhshëm të letërsisë, sigurisht që emrin e poetit Nexhat Pustina do ta vendosin në kontekstin e një metodologjie më të avancuar të vlerësimit teoriko-kritik, duke i dhënë kështu kësaj poezie vendin e merituar në korpusin e përgjithshëm të hapësirës poetike shqiptare.



1

Në një konferencë, që më pas u bë e famshme, në vitin 1939 në Nju-Jork, Tomas Mani, duke përmendur grindjen, gjithashtu të famshme, midis poetit të madh, Firdusit, autorit të "Shah-namesë", (Librit të mbretërve) dhe Shahut të Persisë, për punë honorari, thotë se ngjarje të përmasave të tilla mund t'u ndodhin vetëm poetëve të mëdhenj epikë.

Në të vërtetë e dimë, madje është një nga kureshtitë e para që mësojnë nxënësit e botës mbarë në lëndën e letërsisë, grindjen e shtatë qyteteve greke, për t'u shpallur si vendlindja e Homerit. Është e njohur, madje aq banalisht e njohur, sa që rrezikon të tingëllojë turpëruese për atë që e përmend, hamendja nëse ka qenë Shekspiri apo shumë i dijsmi Bejkon, autori i vërtetë i dramave të famshme. E kështu me radhë. Mikelanxhelo, që i ra me çekiç shtatores, për t'i thënë: pse s'flet, gjer te shpjegimi i prerjes së veshit prej Van Gogut etj., etj.

E vërteta është që bota ka qenë dhe mbetet tepër e kursyer për rrëfime apo, më saktë, mite të tilla, një arsye më tepër kjo që ato, ashtu si gërmadhat e tempujve, të ngjajnë edhe më të çmuara.

E parë në një kënd më të gjerë, dukuria s'është aspak e rastësishme. Ashtu si folklori botëror është shpjeguar me të drejtë si një vizion artistik i botës, që i kundërvihet atij që krijon letërsia, artet, shkollat, akademitë, duke përfshirë këtu edhe famëkeqen propagandë zyrtare, ashtu edhe këto gojëdhëna për shkrimtarët, në dukje naive, janë një përpjekje, natyrisht e druajtur, e një pjese të njerëzimit për ndërhyrje në atë tryezë, në dukje solemne e të largët për të, ku flitet për letërsinë dhe artet.

Kjo është, për fat të keq, shumica e njerëzimit. Ajo nuk ka mundësi të shkollohet e të kuptojë në thellësi librat dhe artet. Madje, një pjesë e saj ende nuk di as shkrim e këndim. Ndërkaq, këta njerëz e dinë se kolosët për të cilët flitet kudo, kanë qenë ose janë banorë të këtij planeti që quhet Tokë. Pra, në njëfarë mënyre, kanë qenë ose janë bashkëvendës me ata. Nga ana tjetër, ata kanë dëgjuar diçka për librat e këtyre kolosëve e, natyrisht, për personazhet e këtyre librave. Ata nuk e kuptojnë mirë gjuhën e tryezës së madhe solemne, por, ndërkaq, disa personazhe që kolosët kanë krijuar, për çudi, i ndiejnë të afërt. Ata e kuptojnë mirë marrëzinë e Don Kishotit, ngaqë diçka u kujton nga dalldisjet e tyre. Tremben nga fisi i Agamemnonit, ngaqë në fisin e tyre, diçka e turbullt gjithashtu ka qenë afruar. Dhe, dëshirën për hakmarrje të princit Hamlet, e kapin pothuajse plotësisht.

Është e mjaftueshme kjo që, ndonëse nuk i kuptojnë shprehjet, të ndjekin nga larg fjalët, zhurmën dhe dritat e tryezës së madhe të artit.

Festa, për fat të mirë, vazhdon. Pak vite më parë kishim shtatëqindvjetorin e Dantes, tani katërqindvjetorin e Don Kishotit, së shpejti, më 16 prill 2016, një katërqindvjetor tjetër, i dyfishtë, kur brenda së njëjtës ditë e braktisën këtë tokë Shekspiri dhe Servantesi.

E druajtur si më parë, pjesa e pashkollë apo gjysmë e shkolluar e njerëzimit, rri në gjysmëhije, me tundimin e hershëm të thotë edhe ajo një fjalë në këtë trazim. E ngaqë kjo u duket e pamundur, në heshtje e në gjysmëmerr bluan mendimet e saj. Dhe përfytyron kështu karvanin me mushka të ngarkuara me flori, domethënë honorarin e poetit Firdusi, që u grind me mbretin, honorar i cili, pas pendimit të këtij të fundit, mbërriti, më në fund, në njëren portë të qytetit, në kohën që nga porta tjetër po dilte tabuti i poetit.

Kështu ndodh ky proces ende i pastudiuar mirë, i ndërhyrjes anonime të njerëzimit, në aventurën e madhe të letërsisë dhe të arteve. Sado naive të duket, kërkesa për ndërhyrje vjen nga thellësitë, ndaj ajo duhet të ketë një shkak. Dhe s'janë të rralla rastet kur ajo ofshamë e thellë qëllon të

ISMAIL KADARE

Don Kishoti në Ballkan

Në zanafillë të kësaj sprove janë shënimet për një konferencë, mbajtur në Bibliotekën Kombëtare të Spanjës, në Madrid, më 1994.

Një version i parë i sprovës, përkthyer prej spanjishtes nga Mira Meksi, sipas pasqyimit të konferencës në shtypin spanjoll, u botua më pas në Tiranë, në përmbledhjen "Unaza në kthetra".

Ky tekst përfundimtar i sprovës është plotësuar prej autorit në vitin 2005. U botua për herë të parë në Shqipëri në kolanën me njëzet vëllime.



jetë më e saktë se shpjegimet e lodhshme të librave të tërë.

Një dëshirë e turbullt për kthim në zanafillë, atje ku trazimet artistike të njerëzimit ishin ende të ndryra në mitrën e errët të kaosit? Nuk e besoj. Është më tepër një dëshirë për mirëkuptim ndërnyerësor.

2

Nganjëherë qëllon që gojëdhënat për shkrimtarët e pazakonshëm lindin larg, madje tepër larg vendeve dhe popujve të tyre. Një gjë e tillë është edhe më prekëse. Një tjetër truall e një tjetër gjuhë, njerëz që s'kanë pasur asnjë lidhje me atdheun e shkrimtarit, vrasin mendjen e fantazojnë për të. Kështu ka ndodhur me Migel Servantesin. Jo në Gadishullin e tij Iberik, por në një tjetër gadishull, fare pak të ngjashëm me të, më tepër me nam të keq se të mirë, në malet e Ballkanit.

Ka kohë që në këto male të largëta e me borë ka lindur e vazhdon ende sot një gojëdhënë e ngjashme me atë që përmend Tomas Mani. Është njëfarë polemike apo grindjeje që s'ka të bëjë me vendlindjen e gjenit spanjoll, as me autorësinë e veprës së tij, por me tjetër gjë: me vendin ku e ka bërë burgun disavjeçar Servantesi, në Algjeri apo në një skutë të Ballkanit.

Siç shihet, puna e burgimit të shkrimtarëve vazhdon të trazojë fantazinë e popujve, ndonëse dy shekuj më parë, kur gojëdhëna ka zënë fill, këta popuj ishin ende analfabetë. Shkrimi i gjuhëve të tyre ishte i ndaluar nga Perandoria Otomane, kështu që ata, jo vetëm s'kishin lexuar asnjë faqe të Servantesit, por as emrin e tij nuk e shqiptonin të saktë. Por kjo nuk i ka penguar

aspak të thurnin një legjendë për të, një polemikë për burgosjen e tij, pavarësisht se atë e trajtonin ndryshe nga studiuesit, akademikët apo Amnesty International e sotme.

Para disa vitesh, një folklorist shqiptar, qëmtues gojëdhënash dhe kronikash mesjetare, botoi në shtypin shqiptar të Kosovës disa historiza që lidheshin me Migel Servantesin, histori të kaluara gojë më gojë dhe që ende rrëfeshin nga pleqtë e moçëm. Në bazë të këtyre rrëfimeve, studiuesi ka hedhur tezën se ka gjasë që Servantesi nuk ka qenë i burgosur në Algjeri, siç besohet, por në një limer midis bregdetit shqiptar dhe atij malazez. Në rrëfimet e moçme tregohet se shumë kohë më parë, në këtë vend, ka qenë burgosur një rob spanjoll i ditur, madje fort i ditur, nga ata që shkruajnë libra. Ngaqë ishte i tillë, kishte shumë miq atje në Spanjën e largët, dhe këta miq dërgonin herë pas here njerëz dhe flori për ta liruar. Emri i robit herë shqiptohet Servat, herë Servet, e herë midis të dyjave. Të gjitha rrëfimet përkiten në një pikë: që robi ishte i ditur fort, dhe që miqtë e tij rrekeshin ta lironin me çdo kusht.

Studiuesi beson se ka gjasë që Servantesi, ndoshta pa e ditur as vetë, të ketë qenë rob në Ballkan, sepse bregdeti shqiptaro-malazez është plot guva e shpella të përshtatshme për piratët.

Kjo zonë ka qenë gjithmonë e dëgjuar për pirateri të madhe, dhe skafistët e sotëm, qoftë shqiptarë, qoftë malazez, që merren me trafik droge, njerëzish apo prostitutash, nuk janë veç pasardhës të një armate të pafund piratësh, që kanë bërë pak a shumë këtë gjë qysh nga koha e romakëve.

Në gojëdhënat e pleqve shqiptarë nuk përmendet Arnaut Mami, pirati që, siç thotë

vetë Servantesi në "Don Kishotin" e tij, e zuri rob shkrimtarin. Emri Arnaut (Arnaute në tekst), do të thotë shqiptar, por pleqtë, me sa duket, nuk e dinë këtë fakt. Në një tjetër episod, një rob spanjoll rrëfen se si mundi të arratisë i veshur si shqiptar (arnaute në tekst). Por pleqtë, ngaqë nuk e kanë lexuar kurrë "Don Kishotin", nuk mund ta dinë as këtë. Mosdija e tekstit vërteton se dëshmia e pleqve lidhur me vendburgimin e shkrimtarit është e pavarur, po të përdornim një shprehje të kohës sonë.

Në zanafillën e polemikës, nëse do ta quanim kështu për t'i dhënë një emër më të fismë gojëdhënës, ka gjasë që Servantesi vetë të ketë gisht. Në tekstin e "Don Kishotit", duke rikujtuar burgimin e tij, ai përmend edhe Algjerinë, edhe emrin e komandantit të piratëve që e zuri rob, Arnaut Mamit, pra Shqiptar Mamit. Është ky një mjegullim i njohur i pistave, që shkrimtarët e bëjnë shpesh, apo, ashtu siç u tha më lart, Servantesi vetë nuk e ka ditur ku ka qenë i burgosur? Në rast të kësaj hamendjeje të fundit, nuk përjashtohet që piratët, të cilët kanë qenë të shquar për mbajtje të fshehtash, sidomos ato që lidheshin me thesaret e groposura dhe me limeret ku mbanin pengjet, ta kenë mashtruar shkrimtarin, duke i thënë se ndodhej në Algjeri dhe jo në burg shqiptar. Kështu që, edhe kur e kanë sjellë të lidhur në guvën buzë Adriatikut, edhe kur e kanë nxjerrë andej për ta liruar, Servantesi ka kujtuar, ashtu si personazhi i tij i ardhshëm, Don Kishot, se ndodhej tjetërkund.

Sidoqoftë, dhe këtë fjalë mund ta shkruajmë me shkronja të mëdha, sidoqoftë, edhe nëse kjo histori është pjesërisht e vërtetë, ose aspak e tillë, thelbi i saj është mallëngjyes, për të mos thënë i madhërishtëm. Sepse është vërtet një gjë e rrallë për një shkrimtar, që, në një truall mijëra kilometra larg vendit të tij, pleqtë analfabetë ballkanas, të mbajnë në kujtesë emrin dhe fatin e tij.

3

Kjo zhvendosje në Ballkanin e largët e fantazisë për Servantesin, në pamje të parë mund të duket një trill rrethanash. Një nga ato trillet e shumta që shoqërojnë aventurën njerëzore. Ngjan vërtet tejet e çuditshme që njerëzit e sertë të këtij gadishulli, të prirur më shumë për kacafytje e më pak për meditime të stërtholla filozofike, të drejtonin vëmendjen ndaj fatit të pikëllueshëm të një shkrimtari spanjoll. Mirëpo, nga një tjetër pikëshikim ka gjasë të ndodhë e kundërta, dhe ajo që na u duk paradoksale, të na shfaqet tani si diçka e logjikshme, e natyrshme, gati fatalisht e pritur.

Midis tre gadishujve jugorë të kontinentit europian, Ballkanikut, Apeninit dhe Iberikut, prej shekujsh gjëllon një marrëdhënie e fshehtë. Në rrafshin e gjenisë, që lidhet me letrat, këta tre gadishuj kanë prodhuar së paku një të tretën e thesarit botëror. Është fjala për poemat homerike, tragjedinë greke, poetët latinë, Dante Aligjerin, dhe së fundi Servantesin. Bashkë me Anglinë dhe Irlandën, nëse do t'i merrnim për një gadishull të katërt, të munguar, do të kapej, ndoshta, gjysma e thesarit.

Përkime të tjera, që s'kanë të bëjnë me artin, i lidhin këta gadishuj. Secili prej tyre ka pasur punë me ngrehina perandorake, e për të tjerë të lemerishme. Në krye të listës qëndron Ballkani. Ai ka pasur punë me pesë perandori: persianen, romaken, bizantinën, otomanen, së fundi sovjetiken. Duke hyrë në makinat e rrotat e tyre monstruoze, këta popuj kanë dalë prej tyre të trandur, disa herë aq fort, saqë ende sot nuk çlirohen dot prej maktheve. Gadishulli Apenin polli Perandorinë Romake dhe qytetërimin latin, që e vuri atë në marrëdhënie të ndërlikuara me krejt Europën dhe pellgun e Mesdheut. Së fundi, Gadishulli Iberik, pas aventurës ushtarako-fetare-kulturore me arabët,

këtë rast është në një kah të kundërt. Ndërsa Spanja i pushtoi hapësirat amerikane, Ballkani u pushtua nga një perandori me hapësira të mëdha. Do të ishte pak a shumë e njëjta gjë sikur Spanja të pushtohet nga indianët e Amerikës.

Perandoria Otomane krijoi raporte aventuriste me popujt ballkanikë. Ajo kishte qindra-mijëra ushtarë të mirë (domethënë të bindur, madje tepër të bindur), por i mungonin oficerët e nivelit të lartë. Kishte nevojë, me sa dukej, për çmendurinë ballkanase. Kështu shpjegohet që ushtria otomane e krijoi elitën e saj kryesisht me oficerë të lartë ballkanas. Tradita vazhdon deri në ditët tona, dhe ndoshta është pikërisht ajo që shpjegon ende sot frymën laike në ushtrinë turke.

Kur perandoria kolosale u shpërbë, të gjithë këta oficerë dhe mercenarë, bashkë me shqytarët e tyre mbetën pa punë. Këtu e gjen peshkopi paralelizmin midis këtyre bjerrakohësve ballkanas dhe Don Kishotit e Sanço Pançës, që s'kanë shkuar në Amerikë, por bredhin poshtë e përpjetë, duke ëndërruar kthimin e së kaluarës.

Kur peshkopi shqiptar thotë se Gadishulli Ballkanik ka qenë e vazhdon të jetë i mbushur me Don Kishotë, kjo është e kuptueshme. Në çdo trevë ku ka gërmadha perandorish e epokash të përmbysura, mbijndë gjithmonë personazhe të tilla. Ballkani është i pasur në kësi gërmadhash. Të fundit prej tyre, atë të perandorisë komuniste, ende e ka nëpër këmbë sot, në vitin 2005! Ndaj tani për tani nuk ka ndonjë shpresë që figura e Don Kishotit t'i ndahet gadishullit.

Siç e pamë më lart, vetë peshkopi shqiptar e ka përkthyer "Don Kishotin", duke qenë dashur padashur i identifikuar me të. Kaq fort ndihet kjo, sa që në përkthimin e tij ka ndodhur diçka që nuk besoj se gjendet në ndonjë tjetër. Në tekstin e Servantesit qëllon që ndonjë emër fshati i humbur i Mançës zëvendësohet befasisht natyrshëm e si në ëndërr me emër katundi shqiptar.

Në këtë kah, s'do të tingëllonte si trill a si diçka e kërkuar që, në faqen e parë të botimit shqip, të shkruhej: "Don Kishoti i Mançës" i përkthyer nga një Don Kishot shqiptar.

Identifikimi i peshkopit përkthyes me heroin e vrerosur, nuk kishte si t'u shpëtonte armiqve të tij të shumtë. Ishte një rast i mirë që kundërshtari i parë i mbretit të quhej me përcmim Don Kishot!

Por ky nuk ishte as rasti i parë e as i fundit. Nis këtu një histori tjetër: ajo e abuzimit me emrin e personazhit të famshëm. Jo vetëm në Ballkan, por kudo. Jo veç në shekujt e shkuar, por në ditët tona.

Është vështirë që të gjendet sot një klan, një forcë politike, një prijës, një shtet a një doktrinar, që të mos jetë tunduar ta shpallë kundërshtarin e vet si një Don Kishot. Komunistët, për shtatëdhjetë vjet me radhë, i kanë akuzuar liderët perëndimorë si të tillë, e të njëjtën gjë kanë bërë këta të fundit me komunistët. E kështu me radhë, e kështu të gjithë.

Don Kishoti, jo më libri, por heroi i tij, vazhdon të gjendet kështu midis vringëllimës së shpatave dhe zhurmës së marrëzisë. Përfundimi i kësaj "daljeje të fundit" të Don Kishotit, është më se i pikëllueshëm. Ashtu si më parë, ndonëse në kulmin e namit të tij, Don Kishoti del përsëri i humbur. Të gjitha ato personazhe që krahasohen me të, e sidomos politikanët, nuk janë veç njerëz të vesit e të kimit, thënë shkurt, ca horra që nuk kanë asnjë grimë nga fisnikëria e hidalgos spanjoll.

Duke u përdorur si sharje apo përcmim donkishotizmi dhe Don Kishoti vetë pësuan dhunimin më të madh të mundshëm. Një nga kulmet e këtij paroksizmi ishte kur një shtet i tërë, një shtet ballkanas, i egër e i prapambetur e që mëtonte, ashtu me rrecka, siç ishte, të mbronte nderin e humbur të marksizëm-leninizmit në shkallë planetare, u krahasua me Don Kishotin. Ky shtet ndodhet në Ballkan dhe është atdheu

i shkruarit të këtyre radhëve, Shqipëria.

Gojdhëna e pleqve analfabetë ballkanas ngjan vërtet një shenjë profetike.

7

Keqpërdorimi i figurës së Don Kishotit na rikthen te një dukuri e njohur, por ende pak e studiuar, ajo e marrëdhënëve jetë-letërsi. Klisheja e vjetër populiste, e përfaquar më pas me aq zell nga marksizëm-leninizmi se "letërsinë e pjell jeta" ose "letërsia pasqyron jetën", duket se ka mbyllur tani për tani dyert për shqyrtimin kritik të saj.

Mjafton të bëjmë disa pyetje, në dukje të thjeshta, që klisheja të tronditet, për të mos thënë të bjerë. Në qoftë se do të pranojmë se letërsinë e pjell jeta, atëherë kemi të drejtë të kërkojmë disa saktësime. Dhe saktësimi i parë është se ç'kuptojmë në këtë rast me fjalën "jetë" (ose "jetë e popullit", siç është përdorur zakonisht nga populizmi). A e pranojmë se është "jetë" - kronika e gjerë e një epoke, me ngjarjet themelore dhe ato të përditshme, qofshin ekonomike, ushtarake, politike, kulturore, fetare, zakonore etj., etj. - po aq sa është "jetë" ajo që ndodh në trurin e një njeriu? Pranimi i kësaj e bën të pranueshme tezën e jetës si amë të letërsisë. Mospranimi e hedh poshtë.

Në rastin e Migel Servantesit ne pamë vetëm një shembull se si në trurin e tij, në rivalitetin midis rropamës së epokës dhe një ngjarjeje të paqenë, njëfarë shajnie (halucinacioni), fitoi kjo e fundit, dhe, falë kësaj fitoreje, ne patëm "Don Kishotin". Shembuj të tjerë dëshmojnë se një pjesë, madje një pjesë tepër e fisme e thesarit botëror të letërsisë, s'ka të bëjë me atë "jetë" që kuptojmë ne. Ajo është një jetë e ndryshme, shpeshherë janë zona të errëta e shpesh zona qiellore të saj, disa herë pjesë të ndërmjetme, e disa herë ato treva ku jeta u afrohet kufijve të vdekjes.

Për t'u kthyer te një çështje më e rrokshme: kalimi i personazheve nga jeta në letërsi dhe nga letërsia në jetë, falë përvojës sonë në këtë botë plot vendkalime kufitare, porta doganore e kontrole pasaportash, ne e kemi lehtë të përfytyrojmë këmbimin e dyanshëm të personazheve, si një vendkalim me dy porta. Në të parën, personazhet që hyjnë nga jeta në letërsi. Në të dytën, rrjedha e kundërt, personazhet që dalin nga letërsia për të hyrë në jetë. Porta e parë, si

porta më normale, është mjaft e gjerë dhe qëndron natë e ditë e hapur. Porta e dytë, përkundrazi, jo vetëm që është e ngushtë, por hapet rrallë, shumë rrallë.

Nëpër këtë portë të dytë të ngushtë ka dalë Don Kishoti, për të hyrë në botën e madhe plot zhurmë.

Dukuria, ndonëse e rrallë, është e njohur tashmë. Jeta vërtet i jep personazhe pa fund letërsisë, por edhe letërsia, gjithashtu, i jep jetës.

Ndërsa dukuria është e njohur, mbetet ende i pashpjegueshëm kriteri që përdor njerëzimi për të pranuar këta bujtës të pazakonshëm, pjella të poetëve dhe të shkrimtarëve. Ai i pranon ata, i bën të vetët (i integron, po të përdorim një shprehje moderne), por, siç janë shpesh zakonet e kësaj bote, kërkon një taksë për këtë integrim. Dhe taksa është ndërhyrja e njerëzimit për retushimin e personazhit.

Në pamje të parë duket si një nder i madh për çdo autor që njerëzimi mbarë, madje njerëzimi nëpër shekuj, merr pjesë në modelimin e personazhit. Në këtë rast, autori dhe njerëzimi mbarë vihen në raporte bashkautorësie.

Por jo të gjithë mendojnë se ky është një nder. Gati dy shekuj më parë Frederik Shiler thoshte të kundërtën.

Siç u tha më lart, është vështirë të përcaktohen "kriteret e pranimit" të personazheve të letërsisë në jetën e madhe. Përse Fausti, Makbethi, vëllezërit Karamazov, Edipi, Ajaksi, Agamemnoni, Jozef K., Leopold Blum etj., ndonëse personazhe të mëdha në letërsi, nuk kanë hyrë dot në jetë? Në rastin e Faustit, përse ai jo, kurse Mefistofeli po? E përse s'është pranuar kurrsesi Makbethi, në kohën që gruaja e tij, Ledi Makbeth, ka hyrë me të dyja këmbët? Vitet e fundit, sidomos në vendet e ish-perandorisë komuniste, ajo pati një rikthim të bujshëm, duke shërbyer si figurë krahasuese me disa nga gratë e tiranëve komunistë, sidomos me kinezen Çian Çin, gruan e Maos, me rumunen Elena, gruan e Çausheikut dhe me shqiptaren Nexhmije Hoxha, gruan e diktatorit shqiptar.

Pyetjet mund të vazhdojnë me arsytet e hyrjes së druajtur të personazheve të tilla, si: Akili, Odiseu, Beatrice e Dantes, Hamleti, Ema Bovari, Ana Karenina etj., në kundërti të plotë me hyrjen ngadhënjyese të Jagos e të dyshes Romeo e Zhulieta. E po ashtu, me statusin disi të çuditshëm të Faustit

e të Don Zhuanit, të cilët, të ardhur nga jeta, pas shtegimit në letërsi, i pari mbeti rob i letërsisë, i dyti, me gjithë përpjekjet e Bajronit, të Molierit e të Moxartit, për ta mbajtur në art, u rikthye në jetë, ku është shumë më popullor se në zonën tjetër.

Lidhur me raportet jetë-letërsi mund të thuhet se dy personazhet më të famshme që, ndonëse të ndryshme, kanë pasur fatin e mirë ose të keq të bëhen më popullore, janë Prometheu dhe Don Kishoti. Të dy janë përpunuar prej njerëzimit mbarë, të dy janë rimodeluar dhe, me sa duket, historia ende s'ka marrë fund.

Përkitja e njerëzimit mbarë është tepër e fuqishme. Për të mirë ose për të keq. Prej kësaj përkitjeje Prometheu ka fituar. Don Kishoti, siç u tha më lart, ka humbur.

Shpjegimi është i thjeshtë: Prometheu u ngjiz prej legjendës e më pas prej "atit të tragjedisë", Eskilit, jo i tillë, ashtu siç e njohim ne sot. Figura e tij nga shekulli në shekull u pasurua prej njerëzimit. Doza e heroizmit të tij u shtua, kurse lëkundjet, dyshimet, kompromiset u zbehën. Me këtë njerëzimi mbarë kërkoi rishikimin, qortimin e figurës. Dhe mund të themi se ia arriti. Në jetën e tij të dytë, në jetën e përditshme, Prometheu nuk është i njëjti si në art.

Me Don Kishotin, siç u shpjegua më lart, ndodhi e kundërta.

Ne e pamë se si emri i tij është marrë nëpër këmbë dhe si nderi i tij është cenuar zuzarisht, më keq se në hanet e Spanjës.

Fati i Don Kishotit na bën të ndërgjegjshëm për një të vërtetë të madhe: klima e planetit tonë është tepër e egër për personazhe të tilla, kaq të fisme e të brishta si Don Kishoti. Ndaj, kur ata dalin nga zgrofi i letërsisë, ashtu si foshnja nga mitra e nënës, kjo dalje mund të ketë rrjedhoja dramatike.

Ne duhet ta mbrojmë këtë personazh të madh të njerëzimit. Ende nuk është gjetur mekanizmi i nevojshëm për kësi rastesh. Madje, ndërgjegjja jonë ende nuk është përgatitur për bëma të tilla. Një propozim i tillë mund të tingëllojë i parrokshëm, ashtu si vite më parë kushtrimi për mbrojtjen e hapësirës. Ashtu si idetë për të drejtat e njeriut, në ndonjë fjalim të vetë Don Kishotit, katërqind vjet më parë. Në qoftë kështu, aq më mirë!

Paris, 7 mars 2005

Botuar në librin "Don Quijote alrededor del mundo", Madrid, 2005



"Don Kishoti", nga Salvador Dali

NDOSHTA DASHURI

Sikur e pashë
Pse s'më besoni

Ditën e parë ia behu t'më marrë me vete
Në qiellin e shtatë

Ditën e shtatë
Ia bëra me sy hapësirës së zbrazët
Tek mendoja se është pranë meje

Pa këtë vetmi do të isha i vogël
Ndoshta dashuri

NJË ME NJË

Këputi pullat
Humbe jelekun

Tash jemi një me një

Dashuria të ndryshon
E përsëris edhe unë

Me erën e detit
Preka thellësinë e oqeanit

Një mijë e një herë
E kaq pak

BUKURSHKRIM

Pse ma prishe ëndrrën, a bën ta di ku e ki hallin?

Te zogu i këmbës mbi këmbë pashë.

Pse duhet ta humbim lojën?

Në ëndrrën time erdhën xixëllonjat. Ku ta di unë pse.

Nga pagjumësia plasi këmisha e bardhë.
Paske harruar, xixëllonjat nuk janë as më shumë

e as më pak.

Për të larë mëkatet bota ka ujë.
Ku e ke hallin.

NATYRA DI KU TË NDALET

Nuk po të marr me të mirë
Bëhu i mirë

Në praninë time humbjen time
Ka diçka për t'u fshehur

Përtej shqetësimeve
Nuk e di a u njohëm mirë

Mbylle derën humbe çelësin
Natyra di ku të ndalet

NJË HYRJE DHE NJË DALJE

E kishte
Po-në po
Jo-në jo

Një hyrje
Një dalje
Kushtojnë më shumë se dy-tre eshtra

Ç'të them tjetër
Kush e di lojën
E di

Bota e parë nga Hëna është botë e vogël
Përtej hijes
Bie në gjunjë

Pse e përmende
Sa e pata harruar

Ishte ditë e rrallë
Toka më beson

Duke ecur mbi një litar
I çova fjalë

REXHEP FERRI

Ndoshta dashuri

poezi

MOS MË BJERË NË QAFË

Ajo për fjalën e vet
Nuk gjeti fjalë

I fola për gjëra që digjen
Pavarësisht nga dimrat nga vitet

Nuk është për t'u çuditur
Gjaku kot s'e nis

Do ta njoh kur e harroj

BUKURIA E VETMISË

Si të shpëtoj nga mëkati
Paska ndodhur një gabim

Nga mjegulla që humb durimin
Asgjë më pak se helmi
Për ta freskuar kujtesën
Çka të them

Gjarpri për të qenë i lumtur
Kafshon bishtin e vet

Nga bukuria e vetmisë

A do të jetë dashuri
A kokërr helmi
Mos më bjerë në qafë

Në botë ka dashuri
Që ndez qiririn
Dashuri që shton pikëllimin

Kjo grua që fle e zgjohet si grua
Mbyllet për t'u mbyllur
Me të kaluarën e fshehur

Në bllokun e mermerit të bardhë
Ka diçka
Që na thërret e na kujtohet

Me shekuj të fshehur
Shekujt e mërzhitur
Te Guri i Olimp

ME SHTATË NGJYRA

Vetëm një herë kalimthi e takova
Për të gjetur pikën e kuptimit e ndala

Ajo për një mëkat të bukur
Me shijen e rrezikut hodhi puthje në erë

Për t'i rishkruar të gjitha
Ku e ka shtëpinë

Sa për të zënë miqësi është fotografia
Jo më pak se me shtatë ngjyra

KOZMETIKA I ÇMENDI EDHE PLEPAT

Njeriut papagalli i hyri në kokë. Hop, sa për të thënë, qeshi.

Kozmetika i çmendi edhe plepat. Ironia mbeti sa mbeti e njeriut.

E tillë është matematika.

Nën qerpikun e saj kalojmë natën. Nata tjetër do ngjyrë tjetër.

E PASHË SI QESHI

Kur e vodha me sy i shkoi për shtati
Për një natë pa gjumë e harroi mëkatin
Nga një largësi e afërt e humbi rrugën

Një natë më parë pëllëmbë për pëllëmbë
Mbi trupin e saj rrëshqita
Si tokë pjellore e përjetova

Për botën e një profili ajo prapë afrohet
Krejt afër një dallëndyshe hijen e vet lëshoi
Për të afruar diçka të pa përjetuar

Ti mos e përmend kohën e humbur
As vitet më të mira të jetës
Vizatuesi i portreteve është humbës i lumtur

E kam të vështirë ta besoj

ME SHIJEN E RREZIKUT

Një vajzë nga tavolina tjetër
Më lëshoi një palë sy
Dhe me sy qeshi

Si ta shoh veten çka më gjeti
A t'i çoj fjalë
Ku është ai që guxon

Tani më vjen të pres
Dashuria ime me çka të shërbej
Shikimi nga tavolina tjetër më çmendi

Me famën e rrezikut

E BUKUR POR JO VETËM E BUKUR

Kur e preka në tel
Buza i preku në gaz

Shtati si shtati i saj
Yll që e huton edhe hënën

Kur e qes në dritë
Më zë mëngjesi

Në vallen e hapur të vashave
Dogja shaminë

E bukur por jo vetëm e bukur
Për të po bie në rrezik

Fajin e ka hëna

NË DEGË HARRIMI

Kur kuptova se të dua
Pse nuk humbe
Para se të bëhet vonë

Kur u dogja dhe rilinda nga hiri
As nuk u ktheve as nuk më braktise

Rexhep Ferri

NDOSHTA
DASHURI

Poezi



Onufri



Para se të bëhet vonë

I heshtur kalova shkretëtirën
Dhe harrova se afër një qiri që digjet
Ku ta di për të satën herë

Aty diku në fillim para fillimit
Dy palë sy më shohin
Të qenit e të njeriut

MË PAK FJALË DIGJET LUMI

Ta kam dhënë fjalën se të shoh
Kudo dhe kurdo

Me pak fjalë të kërkoj
Kam kohë për ty

Sa për të ditur ku po shkojmë
Pse t'i tregoj të gjitha

Me pak fjalë digjet edhe Lumi

HESHTJA MË SHUMË SE FJALA

Në ballin e të gjallëve
Heshtja flet më shumë se fjala

Kjo pikturë biblike
Nuk është vetëm e ditëve tona

Për kohën e tashme
Prapë po i kthehet historisë

Për të gjetur diçka
Që e kemi afër

Që nuk e gjejmë menjëherë

NDOSHTA KA NJERI

Nuk është lojë
Edhe sot është vonë

S'ka kush të flet
Është magji

Ndjeva s'ndjeva
Ndoshta ka njeri

VITE DHE JO MAHI

Çfarë teatri kur ndalet drita
Vjen e shkon
Çudi
Vite e jo mahi

Kot i fola
Përtej frikës
Edhe deti punë serike
Peshku i artë

Më mbeti nga vitet kur isha i ri

LARG DHE AFËR

E vodha me sy
I shkoi për shtati

I duartrokita
E harroi shekullin

E shava
E humbi rrugën

Na duhet
Të shohim Hënën

E kam fjalën për Diellin
I thashë

Ajo si grua
Që fle që zgjohet

Larg dhe afër
Shkon dhe kthehet

Kur beson e nuk beson

NË HALL ME TË BUKURËN

Nga nata me hënë
Një vajzë po vrapon pas natës me hënë
Unë i çova fjalë se e prisja

Në kërkim të bukurisë
Për botën që s'ka asgjë për ne
Vetëm gabimet quhen art

Në hall me të bukurën

A KA KUSH QË MË NDIHMON

Vetëm pak hapa larg
Një vajzë po vraponte pas natës me hënë
Unë i çova fjalë se e prisja

I shoqëruar me dritën e hënës
Për botën që nuk tha asgjë për ne
Vetëm gabimet e bukura quhet art

PRINCI I VOGËL NUK ËSHTË NË MESIN TONË!

U nda nga jeta më 6 qershor piktori dhe akademiku i mirënjohur REXHEP FERRI

*

Arti im është më i fuqishëm se unë.

Të gjitha ngjyrat i pagova shtrenjtë. Vetëm e kuqja u derdh. Këtë lojë, tash e
tutje, nuk do ta luaj më.

Imitimi i rilindasve mori fund...

Dielli vizatohet vetë.

E dua shumë.

Sot çdo gjë është e mundur.

Poshtë e lart do të ketë shumë piktorë, shumë poetë. Ata që me kohë i lajnë
sytë kanë lidhje të fortë me muzeun e njeriut.

Më vonë, kur do të vijë një kohë pa mua, nuk duhet qysh, por dikush do ta
nxjerrë një letër nga xhepi dhe do të lexojë:

- Sa keq më vjen! Princi i vogël nuk është në mesin tonë!...

*Rexhep Ferri, "Njeriu po kush tjetër", Onufri

Rexhep Ferri, poet i pikturës

Çdo ditë më qëndrojnë përballë tri piktura të Rexhep Ferrit: njëra në shtëpi, një tjetër në zyrë dhe një në kabinetin e punës në Akademi. Që të tria i kundrova sot me vëmendje: kanë një lirizëm dhe ekspresion të ethshëm. U mendova gjatë ç'ishte kjo. Mbase një tragjizëm nga thellësia e errët e qenies. Rexhep Ferri dinte ta shprehte këtë.

- Mehmet Kraja

Rexhep Ferri është një artist thellësisht modern, me krijimtarinë e tij ai solli një univers kompleks të individualizuar, vepra që mbajnë gjallë kureshtjen e shikuesit dhe nxisin mendimin e tij për të zbuluar paralele me botën reale, të cilën piktori e transfiguron mjeshtërisht.

Rexhep Ferri do të mbetet i paharrueshëm dhe vazhdimisht i studiuar nga kritika dhe historianët e artit.

Ngushëllime të thella familjarëve.

Lamtumirë, i shtrenjti mik!

-Zija Çela

[...] mund të themi pa mëdyshjen më të vogël se vepra e tij, e brendashkruar në periudhën e artit modernist të Kosovës, ka hyrë tashmë në fondin e artë të trashëgimisë së artit pamor shqiptar, për risitë formale moderniste, për talentin e spikatur si artist si dhe për dinjitetin dhe vlerat njerëzore që bart.

Dr. Gëzim Qëndro

marrë nga Rexhep Ferri: Monografi, ASHAK, 2010

NDËRRON JETË AKADEMIKU REXHEP FERRI

Më pikëllim të thellë njoftojmë se sot, më 6 qershor 2024, në moshën 86-vjeçare vdiq njëri ndër piktorët më të mëdhenj të artit shqiptar, akademik Rexhep Ferri.

Akademik Ferri i përket gjeneratës së artë të piktorëve kosovarë.

Rexhep Ferri u lind në Kukës më 1937. Në vitin 1958 mbaroi Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa në vitin 1966 u diplomua në degën e pikturës të Akademisë së Arteve në Beograd. Në periudhën 1974-2005 ishte pedagog në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Ka hapur ekspozita të pavarura në Galerinë e Kolektivit Grafik në Beograd (1968 dhe 1973), në Galeria Darte II Cenacolo, Viçenca, Itali (1969), në Galerinë e Qendrës Kulturore, Beograd (1976), në Galerinë Lambert, Paris (1977) në Galerinë e Muzeut Kombëtar, Nish (1980), në Galerinë e Arteve, Prishtinë (1982), në Galerinë e Arteve, Sarajevë (1983), në Galerinë Vakko, Izmir, Ankara dhe Stamboll (1989), në Galerinë Vakko, Stamboll (1998), në Galerinë Kombëtare, Tiranë (2001), në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2020) etj.

Më 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i kësaj Akademie.

Ka botuar libra me poezi, romane, ese. Veçohen nëntë tituj të përmbledhur në veprat e zgjedhura letrare.

Më 1971 mori Çmimin e Dhjetorit të Kuvendit të Kosovës, ndërsa në vitin 2012, me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, iu dha titulli Qytetar Nderi i Vlorës.

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës u hap ekspozita tij personale me veprat e zgjedhura. Po në Akademi u botua edhe monografia për veprën e tij.

Në respekt të jetës dhe veprës së akademik Rexhep Ferrit, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 7 qershor 2024, në orën 11:00, mbahet mbledhja komemorative dhe më pas, deri në orën 12:00 bëhen homazhe.

Varrimi i të ndjerit do të bëhet në orën 13:00 në varrezat e Prishtinës.

ASHAK-u u shpreh ngushëllime të ndjera familjes, miqve dhe gjithë artdashësve.

NJË GRUA QË QESHTE ME VETE

Një grua qeshte me vete duke ecur,
Dhe fytyra i bëhej e magjishme!
Një grua të tillë, më thoni,
Kush e ka gjetur,
Që të jetë kaq e thjeshtë
Dhe e madhërishme!?

Unë ju gënjej kur them
Qeshte me vete!
Brenda saj ishte një foshnjë
Që seç kërkonte!
Ajo godiste me shkelm se desh të dilte,
Thërriste "mami",
Po veç ajo e dëgjonte!

Kjo grua ishte dyfish e gjallë,
Atje në rrugë,
Ndërsa ish duke ecur!
Ai që do lindte do ishte djalë,
Po edhe vajzë të ish
Prapë do kish qeshur!

25 prill 2014

NË MBRETËRINË E ERRËSIRËS

Gjithmonë ka diell në mendjen
E të verbërve.
Ka sy që duan të shumëzohen
Me sytë e të tjerëve!
Nëpër honet e errësirës
Ku ecin ata,
Është e pamjaftueshme
Veç dashuria e njerëzve!
Ata vërtet s'i gëzohen dot botës,
E çuditshme gjithnjë
Ajo i është dukur!
Fytyrën e tyre
Veç e përfytyrojnë,
Dhe sytë që duan
T'i kenë të bukur!

Ata mbajnë nëpër duar
Çelësat e natës!
Nga dita, asgjë që t'u ndritë
Nuk morën!
Në mbretërinë e errësirës
Ku lëvizin ata,
Vetëm nata e tyre të jep dorën!

Gjithnjë ka diell
Në mendjen e të verbërve,
Ka sy që duan të pjesëtohen
Me sytë e të tjerëve!
Kush hyn brenda tyre
Duhet ta dijë mirë,
Se ata mund të shohin
Edhe përtej njerëzve!

7 dhjetor 2012

KY JAM UNË

Tërë jetën më keni sulmuar,
Unë prapë atje,
Në shtëpinë prej xhami!
Nga gurët që keni hedhur
Mbi mua,
Ka marrë plagë dhe ajri!

Unë hyj në ata
Që vetëm mbrohen!
(Poetët nuk dinë të nisin luftë!)
Në këtë botë shumë gjëra
Do të vjetrohën,
Dhe urrejtja juaj,
Do të humbë!

Tërë jetën më keni sulmuar,
Keni lëshuar mbi mua
Rrufe, vetëtima!

SKËNDER RUSI

Mos m'i merrni mbrëmjet

poezi

Dhe është aq e shëmtuar ardhja juaj,
Siç ka për të qenë
Edhe ikja!

24 tetor 2008

UMBARUAN STINËT

Po bëhen vite
Që vëlla kam dimrin,
Dhe erën e tij të marrë
E kam motër!
Të tre së bashku
Kemi vjedhur pikëllimin,
Që të jetë ca më e qeshur
Kjo botë!

Po bëhen vite
Që kam mikeshë vetminë,
(Kaprolle që i pëlqen
Kudo të jemi bashkë!)
Unë luaj me të,
E kap gjithnjë për brirësh,
(Ata janë pylli
Ku unë e kaloj natën!)

Po bëhen vite
Që po bredh në këtë botë,
Gjithnjë fëmijë
Para saj kam mbetur!
Për dore mbaj gjithnjë
Kaprollen time të vogël,
Dhe flas me miqtë,
Me ata që kanë vdekur!

ZEMËRIMI I NJË GRUAJE

Sot, në mëngjes,
Kam zemëruar një grua,
(Zemërimi i grave qenka
Si zemërimi i lumenjve!)
Ata mezi presin
Që të shtohen ujërat,
Që të dalin nga shtrati
Të hakmerren ndaj njerëzve!
Sot, në mesditë,
Kam përqaftuar një grua,
(Përqaftimi i grave qenka
Si ndezja e zjarreve!)
Është pikërisht ajo

E zemëruara me mua,
Që ka zgjatur duart
E ngrohet pranë flakëve!

Vonë, në mesnatë,
Kam fjetur me një grua,
Me atë që s'kish zbritur ende
Nga pema e inatit!
Ajo i kishte gjithë gjethet
Të rrëzuara,
Si një vjeshtë e trishtuar
Pranë shtratit!

DRITARJA E SHPIRITIT

Në një nga dritaret e shpirtit,
(Vështro me kujdes!)
Kam lënë pakëz vend për ca ëndrra!
Kush futet atje asnjëherë s'del,
Mbetet përjetësisht aty brenda!
Unë dua që ti atje të futesh,
Nuk të prek kurrë pa të pyetur!
Nuk e di nëse me mua ti duhet të puthesh,
Atje, mes rrënojave që mund të kenë
mbetur!

Në një nga dritaret e shpirtit
(Vështro mirë!)
Nga gjithë të tjerët
Ty të mbaj të fshehur!
Aty brenda ti je dita ime e vogël,
Që më ndriçon se rri gjithnjë e ndezur!

16 shkurt 2012

HAPAT E IKJES

Sa herë që ik ti, unë mbetem bosh,
Së bashku me ty largohet edhe ajri!
Hapat e tu të ikjes unë i shoh,
Ngatërrohen me diellin kur dalin!

Sa herë që s'të kam ty, unë vdes,
Si bari kur vjen vjeshta e parë!
Prandaj edhe pranverën unë e pres,
Siç pres kthimin tënd të më ngjallë!

NUK MUND

Nuk mund të të them
Asnjë fjalë përshëndetje,
Asnjë shikim, nuk mund të të
them,
Mos e hiq!
Nuk mund të të them dot
Je hija e kësaj peme,

Që vjeshta e ka zhveshur lakuriq!

Nuk mund të hedh me ty
Asnjë hap timin,
Kohën nuk mund ta vjedh
E të ta jap!
Nga heshtja e saj
Nuk mund të vijë dimri,
Dhe asnjë ditë nuk mund
Të kthehet mbrapsht!

Nuk mund t'i shkoj
Tej për tej universit,
Dhe botës, sy, nuk mund t'i jap!
Nuk mund të ekzistojmë
Për inat të njëri-tjetrit,
Kohën që ka vdekur
Nuk mundem ta kap!

MË DUKET SE

Më duket se kam rënë me ty në dashuri,
Ma thonë sytë që veç ty të ndjekin,
Ma thonë fjalët që veç ty të pëshpëris,
Ma thonë hapat që drejt teje ecin!

SKËNDER RUSI

mos m'i
merrni
mbrëmjet

OnufriLirika



Më duket se kam rënë në dashuri me ty,
Edhe pse e di që nuk më do aq shumë,
Ditët do t'i ndajmë më dysh ne të dy,
Ti i ke mëngjeset, mesditat i kam unë!

11 dhjetor 2012

OKEJ

E kam mësuar përmendësh
"Formulën e Pagëzimit",
Janë fjalë që s'di ku më çojnë!
Po mua më duhet një formulë tjetër,
Që e përdorin veç ata që dashurojnë!

Kam marrë vesh
Se jeni bërë dimra kundër meje,
Miq të e mi,
Që ju kam dashur më tepër!
Po kjo nuk është shkak
Për të vrarë veten,
Kjo është normale në një botë të egër!

Më gjeni një formulë të re, ju lutem,
Që unë këtë mjegull ta shpërndaj!
Në dashuri sa më pranë njëri-tjetrit të jesh,
Aq më shumë mund të bësh faj!

22 shtator 2015

DITA DHE UNË

E zura "të dashur" ditën,
Isha poet me të,
Gjer në mbrëmje vonë!
E preka edhe atje
Ku përkëdheljet linden,
(Jo çdo gjë që iu ndodh,
Ditët e tregojnë!)

Nuk e ka fajin Shekspiri
Që krijoi Jagon,
As Gëtja për Mefistofelin
Nuk ka faj!
Nëse ka pasur një Salier të neveritshëm,
Kjo ka ndodhur se ka patur një Moxart!

Okej,
Më mirë me ca "miq" më pak!

5 shkurt 2006

NJË MACE MBI ÇATI

E zura "të dashur" ditën,
Kjo e gjitha u quajt
Një skandal i madh, !
Dashurinë ajo e ka për të gjithë,
Por ja që mua më shumë
Ajo më fal!

Nuk mbahet mend kaq shumë mjegull,
Sikur të ishim në Angli,
Një mace rend tjegull më tjegull,
Se çfarë kërkon s'e di njeri!

Një mjaullimë si një sinjal,
Mjegullën e çan tej e përtej,
Kjo mace mbi çati bën vrap,
Kërkon një gjë që unë s'e gjej!

Unë nuk e diel
Çdo të ndodhë nesër,
Do të jem brenda saj
Apo do të jem jashtë!?
Sot, të dy me të,
Kemi një të sotme,
Po një të nesërme
A do ta kemi bashkë!?

16 mars 2011

MARRËZITË E MIA ME NILIN

I llaa sytë me ujin tënd,
Dhe syzet flaka s'di s'e ku,
Në djall të vene dhe plus minuset,
Se shoh më mirë me ujin blu!

Nuk mbahet mend mjegull si kjo,
Këmbët na ikin nuk dimë se ku!
Një mace mbi çati vrapon,
Dhe seç ka humbur që rend ashtu!

LAMTUMIRA

Ishte një lamtumirë, jo më shumë,
Që shkëmbyem ne me njëri-tjetrin!
E ka një burim, unë them, çdo lumë,
Siç e ka një vdekje sapo prek detin!

Mora një varkë me qira,
Por, ah, dollarët më shkuan kot!
Më erdh' një zë, hidhu më tha,
Dhe me gjithë rroba bëra not!

Gjeta një grua më në fund,
Një egjiptiankë peri të bukur,
Por ngaqë shihja veç nga ty
Në vesh ia dhashë një të puthur!

Çdo ditë e bëj një marrëzi
Dhe s'di kush është më tepër shkak,
Por nëse fajin do ta ndash ti,
E di, që do më lësh më pak!

5 Nëntor, '98

KUR BIE BORË

Ti bëhesh më e bukur kur bie borë,
Ngjan me të sikur të ishe fluturimi i saj!
Në sytë e tu ka vetëm zogj dimërorë,
Jo nga ata që ikin e kthehen në Maj!

Brenda tyre jam edhe unë,
Gjithnjë me frikën se mos jam tepër!
Ma hapni zemrën dhe do të gjeni një pyll,
(Janë sytë e saj tmerrësisht të gjelbër!)

Në atë pyll më pëlqen të luaj,
Mbi qerpikët e saj më pëlqen të vdes!
Bie borë dhe unë të dyjave ju dua,
Të dyjave ju pres!

Nuk e di ç'mund të mbetet pas një
lamtumire,
(Mes nesh u vendos një armëpushim!)
As ti s'kishe të drejtë, me të tjerët të flisje,
As unë, me të tjerët, padyshim!

Para nesh kalojnë të katër stinët,
Nuk e dimë në cilën prej tyre kemi qenë!
Një herë, unë them, brenda në dimër,
Një here në vjeshtë kur gjetet kishin rënë!

Por vjeshta dhe dimri, ti thua, kam qenë
unë,
Nuk ka lindur ende ai që të ndërron ty
mendjen!
Do desha që këtë lamtumirë ta kishe prej
meje
Dhe asnjëherë mos kishte një lamtumirë
tënden!

MË TEPËR SE NJË EVË

Kjo botë është gjysma e saj me gra,
Që na e bëjnë të bukur Planetin!
Unë brenda jam, zërit të saj!
Të tjerat duhet që të heshtin!

Ajo është më tepër se një Evë,
Përpara saj unë s'vë asnjë!
Të bukurat Zoti mund të zgjedhë,
Por unë kam zgjedhur veç atë!

Ajo është mëngjesi që vjen për mua,
Më zgjon nga ëndrrat ku jam futur!
Nder ato miliona gra të botës,
Ajo ka qeshjen më të bukur!

Ajo është mesdita kur dielli,
Na rri më afër përmbi kokë,
Do marr një grusht prej tij me rreze,
T'i bëjnë dritë atje mbi flokë!

Ajo është mbrëmja që më rri pranë,
Ku unë qetësisht mbështetem,
Ne gjërat e bukura dimë t'i mbajmë,
Ato që veç një herë na jepen!

KUR QAN NJË BURRË

Ti nuk e di që burri yt ka qarë,
fshehur prej teje dhe prej botës,

mes grushtash kokën e ka marrë
ky fëmijë që i ngjante foshnjës!

Dhe shkak je ti, je vetëm ti,
Se zemra veç për ty i rreh,
Kudo që shkon e di ai
Atë e dimë edhe ne!

Ti nuk e di që burri yt ka qarë,
Fshehur prej meje dhe prej botës,
Dhe shkak je ti, e vetmja ti,
Nën këtë qiell rënduar lotësh!

Ai jeton me ty dhe vetminë,
Me ty edhe pa ty ai ka fjetur,
E do dhe ai pak dashuri ta ketë,
Se s'është i gjallë, por as edhe i vdekur!

8 mars 2017

URIMI I PAZAKONTË

E kam dhe unë një ditë
Jo si të tjerat,
Kur dielli vjen vetë, pa i thënë!
E kam një xhep këtu thellë,
Tek zemra,
Ku ditët më të bukura kam vënë!

Kemi njëmijë e ca vjet që jemi bashkë,
Unë jam bërë ti dhe ti, unë!
Ti ikën gjithnjë,

Unë të vij nga pas,
Me hapat e fladit, pa të bërë zhurmë!

Të kam dashur gjithnjë,
Siç ke dashur ti,

Jo se mua më është dukur kështu!
Bota mund të ketë miliona dashuri,
Po sa jetë e verbër pa sytë e tu!

Kujtoja se do isha veç e lumtur,
Të paktën kështu më premtove ti!
Po them që prapë s'ka gjë më të bukur,
Se sa kur e pjesëton çdo dashuri!

Sa shumë urime ke nga Korça,
Po mua më duken pak për këtë ditë!
Merr edhe urimin tim të pazakontë,
Se firmën e kanë vënë Perënditë!





DEA OPEN AIR INTERNATIONAL FILM FESTIVAL 9-13 June 2024

Në datat 9 deri më 13 Qershor 2024, Festivali Ndërkombëtar i Filmit DEA OPEN AIR, do të zhvillojë edicionin e tij të njëmbëdhjetë në kryeqytet!

Pas pesë vitesh të suksesshme në Sarandë, DEA vjen këtë vit për herë të gjashtë edhe në Tiranë, për ta ndarë ofertën filmike dhe ekspertizën profesionale evropiane edhe me publikun, studentët dhe kineastët kryeqytetas!

DEA mbetet edhe këtë vit OPEN AIR.

Programi i mbrëmjes së konkurimit kryesor të festivalit, Filmit me Metrazh të Gjatë ofrohet në Kinema DEA OPEN AIR 1 – në Amfiteatrin e Universitetit të Arteve.

Në Kinema DEA OPEN AIR 1 – në Amfiteatrin e Universitetit të Arteve organizohet edhe Ceremonia zyrtare e Hapjes si edhe Mbrëmja Gala e Ndarjes së Çmimeve të Edicionit XI të DEA OPEN AIR International Filmfestival Tiranë – 2024.

Programi i pasdites i konkurimit kryesor të festivalit, Filmit me Metrazh të Gjatë si edhe programet e Filmit Dokumentar, Filmit të Shkurtër dhe Filmit Dokumentar do të ofrohen në Kinema DEA OPEN AIR 2 – Salla BLACK BOX e Universitetit të Arteve, ndërsa programi Cine KO, me fokus kinemanë kosovare, do të ofrohet në COD (Qendra për Hapje dhe Dialogun për Hapje dhe Dialog).

Të gjithë pjesëmarrësit kanë aplikuar në platformat Film Freeway dhe Festhome ose në rrugë të drejtpërdrejtë në adresën e Festivalit.

Aplikuesit vijnë jo vetëm nga vendet evropiane, por edhe më gjerë, duke i dhënë aplikimit – si në edicionet paraardhëse – gjeografi ndërkontinentale.

Filmat e paraqitur dhe autorët që marrin pjesë në konkurrim i janë nënshtruar fillimisht seleksionimit paraprak të komisioneve ndërkombëtare, të mbyllur në fund të muajit Mars.

Në garë për Çmimet DEA komisionet e përzgjedhjes paraprake kanë vendosur të përfshijnë në programin e sivjetëm gjithsej 39 filma nga 25 vende të botës, prej të cilëve 6 në Seksionin e Filmit me Metrazh të Gjatë ose konkurimin kryesor, 19 në Seksionin e Filmit të Shkurtër, 11 në Seksionin e Filmit Studentor dhe 3 në programin Cine KO, me fokus kinemanë kosovare.

Edicioni i Njëmbëdhjetë i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit DEA OPEN AIR zhvillohet me mbështetjen e Bashkisë Tiranë, Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Universitetit të Arteve, të cilët krijojnë atmosferën e nevojshme mikpritëse për prurjet artistike dhe kontributet qytetare nga e gjithë bota.

Specialistët e kinemasë, drejtorët e disa festivaleve evropiane të filmit, aktorët, regjisorët, producentët, por dhe përfaqësuesit e industrisë, kritikët, studjuesit dhe gazetarët e ftuar, i japin aktivitetit gjallërinë dhe komunikimin shumëdimensional, që kinemaja gjithnjë premtion dhe realizon.

Zyra e shtypit
DEA OPEN AIR

Në Seksionin e Filmit me Metrazh të Gjatë konkurojnë filmat: “Djali i Diskos” (Disco Boy) - Giacomo Abbruzzese, Itali, Francë, Belgjikë, Poloni 2023; “Dulçinja” (Dulcinea) - Artur Serra Araújo, Portugali 2023; “Qingji i nënës” (Mommy’s Lambie) - Umut Evirgen, Turqi 2023; “Kretsul” - Alexandra Likhacheva, Moldavi 2023; “Okarina” - Alban Zogjani, Shqipëri 2023; “Gripi” - Felix Schaefer, Gjermani 2021.

Juria e Filmit me Metrazh të Gjatë, e përbërë këtë vit nga: Frank Döhmman (kryetar – Gjermani), Chema González (anëtar – Spanjë), Ylli Pepo (anëtar – Shqipëri), Marco Morini (anëtar – Itali), Naser Shatrolli (anëtar – Kosovë) ndjek Programin e Filmit me Metrazh të Gjatë dhe akordon çmimet DEA për: Filmin më të mirë, Regjinë më të mirë, Skenarin më të mirë, Fotografinë/Kameran më të mirë dhe Aktorin/Aktoren më të mirë në rol kryesor në Filmin me Metrazh të Gjatë.

Në Seksionin e Filmit të Shkurtër konkurojnë filmat: “4 stinët” (4 Seasons) - Bujar Alimani, Jonida Koçi, Shqipëri 2024; “Një fëmijë” (A child) - Bekim Guri, Kosovë 2021; “Poezi për fundin e verës” (A summer’s end poem) - Lam Can-zhao, Kinë 2024; “Bolour” - Helia Behrooz, Iran 2023; “Vezë” (Eggs) - Shinyoo Kang, Koreja e Jugut 2023; “Lojë për fëmijë” (Kids game) - Bernabé Rico, Spanjë 2022; “Zakone të mira” (Le buone maniere) - Camillo Esposito, Itali 2021; “I vogël” (Little) - Meka Ribera, Álvaro G. Company, Spanjë 2023; “Marta” - Aleksandra Zhukova, Gjeorgji 2023; “Kryevepër” (Masterpiece) - Valentin Dielli, Serbi 2023; “Në mal” (On The Mountain) - Anya Raza, SHBA 2024; “Pura” - Carmen Méndez, Spanjë 2024; “Pshëritima të heshtura” (Silent Sighs) - Meryem Jabbour, Marok 2024; “Motrat” (Sisters) - Jordi Sanz Angrill, Spanjë 2023; “Ende këtu” (Still here) - John Graham, Kanada 2024; “Akuriumi” (The Aquarium) - Gianluca Zonta, Itali 2024; “Zemra e pelikanit” (The heart of pelican) - Elise Mc Leod, Francë 2023; “Vastago” - David Luque, Spanjë 2022; “Violinisti” (The violinist) - Saimir Bajo, Albania 2024.

Në Seksionin e Filmit Studentor ofrohen


filmat: “Sera” (Greenhouse) - Lira Keramari, Greqi 2023; “Rreth meje” (About me) - Maryam Tarami, Holandë 2023; “Larg lagjes së vjetër” (Chip off the old block) - Alina Serebryakova, Federata Ruse 2023; “Mikrobi” (Germ) - Lilyana Alexandrova, Bullgari 2023; “Turp” (Shame) - Sonja Sahakyan, Armenia 2023; “Më pranë” (Closer) - Santiago Rivero, Letvia 2023; “Katja shkruan” (Katya writes) - Olga Gagarina, Federata Ruse 2023; “Bifteku” (The steak) - Kiarash Dadgar, Iran 2023; “Murmurita e Melodisë” (Melody’s Murmur) - Fabio Barber, Spanjë 2023; “I pistë” (Dirty) - Iván Sitz, Spanjë 2023; “Zoom” - Emir Akarsllan, Turqi 2024.

Programet e Filmit të Shkurtër dhe Studentor ndiqen nga Juria e Filmit të Shkurtër dhe Studentor, e përbërë nga: Ismail Kasumi (kryetar – Maqedoni e Veriut), Branka Bešević Gajić (anëtare – Kroaci), Blerdi Malushi (anëtar – Kosovë), e cila akordon çmimet: DEA për Filmin e Shkurtër më të Mirë dhe DEA për Filmin më të Mirë Studentor.

Nga këndvështrimi i kontributit të tyre shoqëror, filmat e ofruar vlerësohen edhe nga Juria e Medias, e cila këtë vit përbëhet nga: Alida Cenaj (kryetare), Anila Basha (anëtare) dhe Edi Oga (anëtare) akordon Çmimin Special të Medias në kategorinë e Filmit me Metrazh të Gjatë dhe Çmimin Special të Medias në kategorinë e Filmit të Shkurtër.

Paralelisht me çmimet e mësipërme, organizatorët e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit, DEA OPEN AIR akordojnë edhe dy çmime honorifike: DEAn e Mirënjohjes (Çmim karriere) dhe DEAn Homazh (Çmim përkujtimor), ndërkohë që Bashkia Tiranë ndan Çmimin e Publiku të Tiranës, bazuar në vlerësimin e shikuesve të kryeqytetit.

DEA OPEN AIR ofron edhe filma jashtë konkurimit. Konkretisht, në edicionin e njëmbëdhjetë të DEAs, në kuadrin e programit Cine KO, me fokus kinemanë kosovare, ofrohen filmat: “Shpia e Agës” (Aga’s House) – Lendita Zeqiraj, Kosovë 2019; “Një pranverë e paharruar në një fshat të harruar” (An unforgettable spring in a forgotten village) - Kushtrim Bekteshi, Kosovë 2019 dhe “Heroi” (Hero) – Luan Kryeziu, Kosovë 2014.



SEKRETI I JETËS

nga Susanna Kaysen

Përktheu nga origjinali anglisht:
Miranda Enesi



Një ditë, dikush erdhi për të më bërë një vizitë. Atë çast ndodhesha në sallën e televizorit, me vështrimin nga Lisa që po ndiqte një program. Papritur, aty u shfaq një infermiere, e cila tha:

“Ka ardhur dikush për t’ju takuar. Një burrë.”

I dashuri im, një tip i vështirë, nuk mund të ishte. Pikësëpari, ai nuk ishte më i dashuri im. E si mund të kisha unë të dashur, në një kohë që isha mbyllur në një spital psikiatrik? Sido që të ishte, ai nuk do ta përballonte dot një vizitë të tillë. Unë e dija, se edhe nëna e tij kishte qenë e shtruar në një spital psikiatrik, ndaj, ai nuk ndihej mirë kur ia kujtonin një gjë të tillë.

Që të ishte babai im, nuk kishte gjasë; ai ishte gjithmonë i zhytur në punë.

As mësuesi i anglishtes në shkollën e mesme nuk mund të ishte. Ai qe pushuar nga puna, dhe më pas, ishte shpërngulur në Karolinën Jugore.

Shkova për të parë se kush kishte ardhur. Ai po qëndronte në këmbë pranë një rreze prej dritareve në dhomën e ndenjjes, duke soditur jashtë: ishte shumë i gjatë, supet i kishte të rëna si ato të një akademiku, nyjat e dorës i dilnin jashtë mëngëve të xhakëtës, kurse flokët e zbërdhulët i kërcenin nga koka si një krifë luani. Kur dëgjoji hapat e mia, në çastin që po futesha në dhomë, ai ktheu trupin nga unë.

Ishte Jim Watson. U lumturova kur e pashë, pasi në vitet pesëdhjetë, ai kishte zbuluar sekretin e jetës, dhe ndoshta tani, atë, do të ma tregonte edhe mua.

“Jim!” thirra unë.

Me një hap të ngathët, ai bëri drejt meje. U afrua dalëngadalë, duke u lëkundur dhe njëkohësisht i zbehur, në një kohë që pritshmëria ishte që ai të bisedonte me njerëzit; gjithmonë më kishte pëlqyer për këtë.

“Më dukesh shumë mirë,” tha ai.

“Pse, çfarë prisje ti?” pyeta unë.

Ai tundi kokën në shenjë mohimi.

“Çfarë po të bëjnë këtu?” pyeti ai si nëpër dhëmbë.

“Asgjë,” thashë unë. “Absolutisht asgjë.”

“Këtu qenka e tmerrshme,” u shpreh ai.

Dhoma e ndenjjes, në veçanti, ishte ndër pjesët më të këqija të pavijonit tonë. Ajo ishte tepër e madhe dhe e mbushur me kolltukë të veshur me material termoplastik, që kërcitnin sa herë dikush ulej në to.

“Këtu nuk është dhe aq keq,” thashë unë, ngaqë isha mësuar aty. Ai nuk ishte.

Me hapa të vegjël, ai u drejtua përsëri

dritares dhe me të mbërritur aty, hodhi shikimin jashtë. Pas pak, më bëri shenjë me krahun e tij të gjatë, që t’i shkoja pranë.

“Shiko.” Ai tregoi diçka me gisht.

“Çfarë të shikoj?”

“Atë.” Gishti tregues ishte drejtuar nga makina. Ajo ishte një makinë sportive e kuqe, ndoshta një MG. “Është e imja,” tha ai. Jim-i kishte fituar çmimin Nobel, ndaj kishte shumë mundësi që makinën ta kishte blerë me paratë e fituara me atë rast.

“E bukur,” thashë unë. “Shumë e bukur!”

Në atë çast, ai filloi të fliste me zë të ulët. “Ne mund të ikim bashkë që këtej,” pëshpëriti ai.

“Qysh?”

“Ti dhe unë, mund t’ia mbathim që këtej.”

“Me makinë, do të thuash?” E kisha humbur fare toruan. Të ishte ky sekret i jetës? Arratisja paska qenë sekret i jetës?

“Kanë për të më ndjekur,” thashë unë.

“Është makinë e shpejtë,” u përgjigj ai.

“Nuk e kam të vështirë të të nxjerr prej këtej.”

Papritur, e ndjeva se duhej t’i dilja në mbrojtje. “Faleminderit,” thashë unë. “Për ofertën. Je shumë i mirë.”

“Nuk do të vish?” Ai përkuli trupin drejt meje. “Nëse dëshiron, shkojmë në Angli.”

“Në Angli?” Ç’hynte Anglia këtu? “Jo, në Angli nuk mund të vij,” ia ktheva unë.

“Mund të punosh si guvernante,” tha ai.

Për dhjetë sekonda përfytyrova një jetë të re, atë me Xhimin, që filloi nga çasti kur u futa në makinën e kuqe dhe pastaj lamë pas me shpejtësi spitalin psikiatrik, në drejtim të aeroportit. Çështja e punësimit si guvernante ishte e megjullt. Në fakt, i gjithë plani, ishte i megjullt. Kolltukët e veshur me material termoplastik, kamerat e sigurisë, gërvima e derës së infermierisë: nuk kishin asnjë grimë megjullimi.

“Xhim, tani për tani, vendi im është këtu,” thashë unë. “Mendoj se nuk duhet të “Në rregull.” Ai nuk shfaqti kurrfarë mërzitjeje. I hodhi një vështrim të shpejtë dhomës për unë qëndrova pranë dritares. Pasi kaluan disa minuta, e pashë tek u fut në makinën e kuqe dhe u largua menjëherë, duke lënë shtëllunga të vogla tymi nga pas. Mbas disa çastesh, u ktheva në sallën e televizorit.

“Përsëritje, Lisa,” thashë unë. M’u bë qejfi që ajo ishte ende aty.

“Mbathjaa!” klithi Lisa.

Në vazhdim, vendosëm të përqendroheshim përpara ekranit të televizorit.

VEPRA E CARAVAGGIO-S E ZBULUAR SË FUNDMI VENDOSSET NË MADRID

Nga Rubert Plummer, BBC

Përktheu Andreas Dushi

Një pikturë autentike e zbuluar tash së fundmi e artistit të njohur të shekullit XVII Caravaggio do të shfaqet në muzeun Prado në Madrid.

Ecce Homo, e cila tregon Poncin Pilat, administratorin romak duke e paraqitur Krishtin para popullit, është një prej rreth gjashtëdhjetë veprave të njohura të mjeshtrit italian, por që desh i ka shpëtuar vëmendjes së botës së gjerë të artit, duke ju atribuar në fillim një artisti më pak të njohur.

Piktura u tërhoq nga shitja me urdhër të qeverisë spanjolle në vitin 2021, pak orë para se të shitej në një ankand me çmim fillestar 1500 euro. Tani, tre vite pas asaj ndërhyrjeje vendimtare, vepra është shfaqur për herë të parë që pas konfirmimit të statusit të saj.

Më heret këtë muaj, muzeu Prado tha se piktura ishte “pa asnjë dyshim, një Caravaggio kryevepër”, duke e quajtur “një nga zbulimet më të mëdha në historinë e artit”.

Caravaggio i cili vdiq më 1610 në moshën 38 vjeçare është i mirënjohur për përdorimin e tij dramatik të dritës dhe të hijeve për të sjellë realizëm të thellë psikologjik në skenat e dhunshme që kryesisht përshkruante.

Historianët e artit e kanë vlerësuar veprën e tij si fillimin e pikturës moderne.

Ecce Homo besohet të ketë qenë pjesë e koleksionit privat të Mbretit Filipi IV të Spanjës para se të ekspozohej në apartamentin e të birit, Karli II.

Ajo u rishfaq në Madrid në prill të 2021, kur u përshkrua si produkt i një artisti që i përkiste rrethit të pikturit spanjoll të shekullit XVII José de Ribera.

Por, pasi ekspertët në Prado ngritën zërin për dyshimet e tyre rreth autorësisë së vërtetë, ministri spanjoll i kulturës e bllokoi shitjen.

Piktura do të jetë e ekspozuar deri në tetor, në një ekspozitë të veçantë, dhe do të vijojë me një marrëveshje me pronarin e ri të saj që beoshet të jetë një britanik i cili jeton në spanjë.

Pas kësaj, telajoja do të zhvendoset në koleksionin e përhershëm të Prados për katër muaj të tjerë. Sipas raporteve të mediave spanjolle, piktura ka kaluar nga njëra dorë në tjetrën për 36 milion euro.

Jorge Coll, drejtori i galerisë së artit Colnaghi në Londër që është marrë me shitjen, i tha gazetës El País se piktura në vend që të përfundonte në shtëpinë e pronarit, do të vijonte t’i jepej për huazim koleksioneve publike.



Shkrimtarja Ani Gjika është autore dhe përkthyes letrare e tetë librave, ndër ta edhe e librave me poezi, "Bread on Running Waters" (Fenway Press, 2013), finalist për çmimin e poezisë Anthony Hecht 2011 dhe për Çmimin May Sarton New Hampshire 2011. Gjika u zhvendos në SHBA kur ishte tetëmbëdhjetë vjeçe, duke fituar të drejtën e studimeve universitare për gjuhë angleze në Atlantic Union College, më pas pëstudimet Master në gjuhë angleze në Simmons University dhe një Master në Artet e Bukura në poezi në Universitetin e Bostonit. Ani Gjika është përkthyes e njohur letrare, fituese e Çmimit të Përkthimit Robert Fitzgerald. Ajo ka përkthyer "Hapësirë negative" (Negative Space) të Luljeta Lleshanakut (2018; WLT, Nëntor 2014, 12) dhe poezi të poetit Xhevdet Bajraj "Vrasja e mushkonjës" (Slaying the Mosquito) (2017). Përkthimi i saj nga gjuha shqipe i vëllimit me poezi "Hapësirë negative" të Luljeta Lleshanakut u botua në vitin 2018 nga Bloodaxe Books në Mbretërinë e Bashkuar, ku ishte përkthimi i rekomanduar i Shoqatës së Librit Poetik dhe në listën e ngushtë për Çmimin Ndërkombëtar të Poezisë Griffin. Libri u botua në të njëjtin vit nga shtëpia botuese New Directions në SHBA, ku ishte finalist për një çmim PEN dhe për Çmimin e Librit më të mirë të Përkthyer.

Gjika është fituese çmimesh dhe bursash për shkrimin krijues nga English PEN, Bursa Globale Robert Pinsky, Bursa Pauline Scheer, 2019, dhe së fundmi, fituese e Çmimit të Librave të Emigrantëve të Rinj të shtëpisë Botuese Restless Books për memuarin me titull "An Unruled Body".

Siç shkruan Kathryn Savage, në recensend e saj për "An Unruled Body" në World Literature Today, mars 2024, "Në memuarin debutues të Ani Gjikes, lexuesi ftohet të mendojë për përkthimin si një përvojë e trupit. Kujtimet e Gjikes, shtrihen në nivel hapësinor global dhe në kohë, duke filluar nga fëmijëria dhe mosha e re të poetes dhe përkthyeses dhe gjurmon jetën e sotme e cila që përfshin Tajlandën, Indinë dhe Amerikën. Gjatë gjithë librit, trupi i rrëfimit funksionon si arkiv dhe si vend përkthimi. Trupi është vendi ku trauma dhe dëshira shfaqen dhe bëhen të njohura. Në këtë memuar kalimi nga vajzëria në të qenët grua, bëhet i dyfishtë duke u bërë njësh me kalimin në një gjuhë të re dhe me përvojat që rrjedhin prej saj. Libri nxjerr në pah kryqëzimin e politikës dhe trupit – të kristalizuar në përsëritjen shqiptare të mitit ballkanik të murimit – dhe të pathënat e ngurosur që shpërfaqen përmes introspeksionit, një lloj leximi nga afër dhe dëgjimi i mesazheve dhe sinjaleve të trupit.

Pas përvojës si mësimdhënëse e Shkrimit Krijues në universitete të ndryshme në SHBA dhe Tajlandë, Ani Gjika aktualisht është mësimdhënëse e të shkruarit, studimeve sociale dhe letërsisë në Shkollën e Mesme Framingham në Masaçuset.

Suzana Vuljevic është shkrimtare, redaktore dhe përkthyes nga shqipja, dhe gjuha boshnjake, kroate, malazeze, serbe në anglisht. Ajo ka mbrojtur doktoraturën në Histori dhe Letërsi Krahasuese në Universitetin e Columbia-s dhe ligjëron Historinë e Ballkanit në Universitetin DePaul.

Suzana Vuljevic: Cila ishte shtypa për ta shkruar këtë libër? Si u formësua?

Ani Gjika: Në të vërtetë nuk ka pasur një gjë të posaçme që më shtyu ta shkruaj, por një grumbullim përvojash që ishin fundosur për një fare kohe dhe filluan të dilnin në sipërfaqe: duke jetuar jetën e një emigranteje, poeteje, përkthyesje, edukatoreje, arritja e moshës madhore në

Intervista në *Chicago Review of Books* për memuarin e autores Ani Gjika botuar në anglisht me titullin, "An Unruled Body".

ANI GJIKA:

Zhdukja e zërit të gruas nga kanoni letrar shqiptar

Suzana Vuljevic

Përktheu: Granit Zela

një vend në tranzicion, më pas largimi prej tij dhe shfaqja e beftë në një kulturë dhe gjuhë të re... Para së gjithash, nuk kisha hasur kurrë personazhe si Ani dhe Ishani, ose prindërit e Anit, apo si gjyshja Meropi, apo një vend si Shqipëria si personazh, në asnjë nga librat që kisha lexuar prandaj doja të shkruaja historitë e tyre.

Suzana Vuljevic: Në panteonin e letërsisë shqipe, zërat e grave mungojnë dukshëm, heshtin dhe fshihen, megjithatë libri juaj mund të shihet si pjesë e një zhanri i cili po shfaqet ngadalë, ai i memuarëve të grave për jetën në komunizëm dhe për tranzicionin, emigracionin dhe më shumë, libër që ka ardhur pas "Të lirë" të Lea

Ypit, botuar në vitin 2021. Si ishte përvoja e krijimit të një libri që i përket një zhanri të ri, pa pika të qarta referimi? Apo, qoftë edhe të bëheshe pjesë e zhanrit të librave autobiografik të grave?

Ani Gjika: Më duhet të përmend këtu redaktoren e kritikës në Asymptote, Barbara Halla, e cila e ka analizuar caq thellësisht dhe në mënyrë të thukët dukurinë e fshirjes së zërit të gruas shqiptare nga kanoni letrar shqiptar në esenë e saj "Peizazh shterp: kush ka frikë nga gratë shqiptare?" botuar në Asymptote më 20 shkurt 2019. Është tradita e gjatë patriarkale e burrave që u dhurojnë dafina burrave në atë kulturë, ndonjëherë vetë shkrimtarët gra e përvetësojnë



mizogjininë (grua-urrejtjen) duke mos përmendur dhe duke mos vlerësuar veprën dhe idetë e kolegeve shkrimtare ashtu si dhe një sistem arsimor që i përjashton shkrimtarët nga programi mësimor, i cili vazhdon t'i bëjë jehonë asaj fshirjeje dhe heshtjeje. Por, në të vërtetë, shkrimtare si Musine Kokalari në vitet 1940 dhe Elvira Dones qysh në vitet 1990, për të përmendur vetëm dy, kanë bërë shumë përmes përmbledhjeve të tyre të hershme me tregime për t'i dhënë dikujt që shkruan sot mjetet se si të shkruajë një memuar. Kjo për shkak se, ndërsa ata shkruanin letërsi, vepra e tyre është e rrënjësor bukur në histori dhe në një traditë gazetareske, të cilat memualet e mira sot priren t'i përfshijnë si duhet. Përveç kësaj, ekziston një traditë e gjatë e grave shqiptare që tregojnë histori në këngë që nga lashtësia. Ceremonitë shqiptare të morit, për shembull, janë të famshme për këtë: ato që vajtojnë janë zakonisht gra që rrëfejnë jetën e të vdekurve dhe ndërtimin e botës në një mënyrë të ngjashme me Odisenë e Homerit. Kështu që unë do të thosha se zhanri i memuarëve, siç është shkruar nga gratë shqiptare, mund të mos përshkruhet saktësisht si një zhvillim i ngadaltë, por ka qenë një tipar i letërsisë shqipe gjatë gjithë kohës dhe kushdo që shkruan memualet sot duhet ta ketë parasysh.

Për sa i përket përvojës sime në shkrimin e prozës, ajo ishte çliruese, së pari sepse shkrova variantin e parë të përafërt për tre ditë në verën e viti 2015 - diçka për një mit që më pëlqen të përmend sa herë që më jepet mundësia, sepse më befasoi për mirë, nuk mund të mos e shkruaja këtë libër, dhe sepse më konfirmoi se nuk jam vetëm një gjë, thjesht poete ose thjesht përkthyes, por një shkrimtare që përdor të gjitha mjetet që zotëron. Kam botuar poezi në anglisht për të qenit emigrant dhe për jetën time në Shqipërinë komuniste dhe postkomuniste që nga viti 2001 dhe libri im i parë me poezi, "Bread on Running Waters", i cili u botua në vitin 2013, përqendrohet në këto tema. "An Unruled Body" i merr dhe i zgjeron ato dhe, duke e shkruar, ndjeva se zhanri i kujtimeve më dha hapësirë për të shqyrtuar çështje më të ndërlikuara gjerësisht dhe në thellësi, ndërsa poezia më dukej e kufizuar në këtë aspekt. Memualet janë shumë të vështira për t'u shkruar mirë dhe nga përvoja personale, ajo që kam vërejtur nga shkrimtarët të tjerë që i admiroj, kërkon shumë kohë për t'u dhënë formë. Memualet nuk janë një zhanër që fillon me një zë të veçantë dhe ne mund të shohim ende njerëz që botojnë pas sa e sa vitesh një libër për të cilin mund të kenë filluar të punojnë që në fillimi të viteve 2000. Më vjen mirë që përmendni memualet e Lea Ypit sepse ky është i vetmi memuar i shkruar nga një shqiptare që ka pasur një ekspozim të gjerë dhe të merituar, por ka shumë gra shqiptare që shkruajnë shqip si dhe në gjuhë të tjera në të gjithë diasporën dhe ne do të



jemi me fat nëse dëgjojmë historitë e tyre kur ato të botohen.

Suzana Vuljevic: Në një pikë, ju shkruani "Duke qenë vajzë apo grua, mëson të barazosh forcën me thjeshtë të ndërjerit rehat në lëkurën tënde" dhe diku tjetër, "Unë e shkrova këtë libër në mënyrë që fjalët nga faqet e asaj kohe në jetën time më në fund të bëheshin bashkë dhe unë të flisja. Dhe kësaj do ta shihja veten. Sepse gjuha është prani, dhe të flasësh do të thotë të bëhesh i dukshëm." Në shumë mënyra, libri në mënyrë të natyrsme dhe të qetë e nxit lexuesin të bëjë pikërisht këtë, të zërë hapësirën e vet, të vetëdijësohet për veten, gjuhën, sistemet shtypëse ndaj grave.

Ani Gjika. Faleminderit. Po, shpresoj se bën pikërisht këtë, duke e nxitur lexuesin t'i kushtoj ndër të tjera, më shumë vëmendje gjuhës. Tashmë kam vërejtur se lexuesit e përshkruajnë martesën e Anit dhe Ishanit si një *dështim* apo si *jofunksionale*, e cila është gjuha që përdoret kur i shohim të tjerët përmes një perspektive të mangët në vend që t'i mveshim dështimin sistemeve mbizotëruese që shtypin si gratë ashtu edhe burrat. Shpresoj se libri vë në pah edhe se si frika mund t'i kthejë jo vetëm njerëzit, por edhe vende të tëra në të huaj për veten e tyre. Shpresoj që lexuesit ta shohin veten në libër, prandaj edhe ballina, e cila i bën homazh legjendës shqiptare të Rozafës që përmendet në libër - por edhe Sheela-Na-Gig, simbol, për mua, i një gruaje që nuk ka nevojë për gjuhën e askujt, aq më pak të qeverisë, për t'i diktuar se si të jetojë në trupin e saj. Nuk ka shtëpi më të shenjtë për dikë tjetër se sa trupi ynë dhe ky libër shpresoj të veprojë si një përkujtesë për këtë, për sovranitetin e trupave tanë.

Suzana Vuljevic: Gjuha është kaq tërheqëse, e bukur dhe poetike. Shpesh na duket sikur po vëzhgojmë botën me syrin e mendjes së një fëmije, ka një risi dhe të çudi tek kjo gjë - ka digresione, fragmente, poezi si pjesë organike e tekstit. A ka pasur shkrimtarë të tjerë që kanë shërbyer si frymëzim apo shembull për ju në shkrimin e këtij libri? Shkrimtarë të cilët ju kanë tërhequr si lexuese dhe të cilët përdorin qasjen tuaj? Me fjalë të tjera, me kë do të thoshit se bashkëbisedon ky libër?

Ani Gjika: Faleminderit për pyetjen! Unë i dua filmat dhe i kam dashur që fëmijë. Mendoj se kur shkruaj, kthehem në kamera. Filloj me një imazh dhe më pas gjej atë që duhet të them. Mund të them se udhërrëfyesit e mi ishin dy në veçanti - Lidia Yuknavitch dhe Katherine Angel. Ato të dyja harmonizohen me shqisat dhe shkruajnë duke u nisur nga trupi më shumë se nga mendja kur zgjojnë kujtimet e përvojave të ndryshme. Po kështu, si redaktorja ime, Jennifer Alise Drew, ashtu edhe mua na pëlqente se si Maggie Nelson luan me tekstin në hapësirën anash, tek libri i saj "Argonautët" dhe mendova t'i kishim fragmentet e poezisë të shpërndara këto hapësira, pranë fragmenteve të cilave u flasim, duke e thyer vijmësinë e prozës nganjëherë në një mënyrë që na bën të duket sikur poezia po na vështron nga një dritare e faqes së librit.

Suzana Vuljevic: Në shumë mënyra, ky libër ka të bëjë me dëgjimin nga afër dhe deshifrimin e gjuhës së trupit. Si e ka ndihmuar roli juaj si poete dhe përkthyes të shkruarit e këtij libri biografik? Sa përputhet apo e reflekton punën që bëni si poete dhe përkthyes?

Ani Gjika. Me të vërtetë që nuk mund t'i ndaj. Jam shkrimtare sepse jam përkthyes, sepse jam poete. E përdor vazhdimisht imagjinatën, duke endur e endur pëlhurën e kujtesës, dhe procesi, pavarësisht nëse jam duke përkthyer, ose jam duke shkruar poezi apo prozë, përfshin të dëgjuarit e vëmendshëm të fjalëve të duhura ndërsa ato kërkojnë dhe gjejnë mishërimin e tyre në çdo fjali.

Dy shkrime mbi natyrën, njeriun dhe vendin tonë në të NGA CARL SAGAN DHE STEVE MARABOLI

Përgatiti dhe përktheu: Xhensila Alla

Pikë e zbehtë blu Carl Sagan

"Shikoje përsëri atë pikë. Është këtu. Është shtëpia jonë. Jemi ne. Në të, të gjithë ata që don, të gjithë ata që njeh, të gjithë ata që ke dëgjuar, çdo qenie njerëzore që ka ekzistuar ndonjë herë, kanë jetuan jetën e tyre. Përmbledhja e gëzimit dhe vuajtjes sonë, mijëra fe të besueshme, ideologji dhe doktrina ekonomike, çdo gjahtar e plaçkitës, çdo hero e frikacak, çdo krijues dhe shkatërrues i qytetërimit, çdo mbret e fshatar, çdo çift i ri të dashuruarish, çdo nënë dhe baba, fëmijë shpresëdhënës, shpikës dhe eksplorues, çdo mësues i moralit, çdo politikan i korruptuar, çdo "superstar", çdo "udhëheqës suprem", çdo shenjtor dhe mëkatar në historinë e specieve tona ka jetuar atje - në një grimcë pluhuri të varur në një rreze dielli.

Toka është një skenë shumë e vogël në një arenë të gjerë kozmike. Mendo për mizoritë e pafundme të ushtruara nga banorët e një cepi të këtij pikseli mbi banorët mezi të dallueshëm të ndonjë cepi tjetër, sa të shpeshta keqkuptimet e tyre, sa të etur për të vlarë njëri-tjetrin, sa të zjarra urrejtjet e tyre. Mendo për lumenj gjaku të derdhur nga të gjithë ata gjeneralë dhe perandorë, në mënyrë që, në lavdi dhe triumf, të mund të bëhen zotat e një fraksioni të një pike.

Pozicionet tona, rëndësia jonë e imagjinuar, iluzioni se ne kemi një pozicion të privilegjuar në Univers,

sfidohen nga kjo pikë e një drite të zbehtë. Planeti ynë është një pikëz e vetmuar në errësirën e madhe mbështjellëse. Në paqartësinë tonë, në gjithë këtë gjerësi, nuk ka asnjë të dhënë se ndihma do të vijë nga diku tjetër për të na shpëtuar nga vetvetja.

Toka është e vetmja botë e njohur deri tani që strehon jetë. Nuk ka askund tjetër, të paktën në të ardhmen e afërt, ku speciet tona mund të migrojnë. Vizituar, po. Vendosur, akoma jo. Na pëlqen apo jo, për momentin Toka është pozicionimi ynë.

Është thënë se astronomia është një përvojë përulëse dhe krijuese e karakterit. Ndoshta nuk ka demonstrim më të mirë të marrëzisë së mendjemadhësisë njerëzore sesa ky imazh i largët i botës sonë të vogël. Për mua, ajo thekson përgjegjësinë tonë për të qenë më të dashur ndaj njëri-tjetrit dhe të ruajmë e të ushqejmë pikën e zbehtë blu, shtëpinë e vetme që kemi njohur ndonjëherë."

Jeta, e vërteta dhe të qënit i lirë Steve Maraboli


Ne të gjithë kemi dëgjuar se asnjë fjollë dëbore nuk është njësoj. Çdo fjollë dëbore merr formën e përsosur për efikasitetin dhe efektshmërinë maksimale për udhëtimin e saj. Dhe ndërsa forca universale e gravitetit u jep atyre një destinacion të

përbashkët, hapësira e zgjeruese në ajër i jep çdo fjollë dëbore mundësinë për të marrë rrugën e saj. Ata janë në të njëjtin udhëtim, por secili merr rrugë të ndryshme.

Gjatë këtij udhëtimi të shtyrë nga graviteti, disa fjolla dëbore përplasen dhe dëmtojnë njëra-tjetrën, disa përplasen dhe bashkohen, disa ndikohen nga era... ka kaq shumë kalime dhe ndryshime që ndodhin përgjatë udhëtimit të fjollës së borës. Por, pavarësisht ndryshimit, ato e gjen gjithmonë veten të formësuar në mënyrë perfekte për udhëtimin e saj.

Unë mendoj se paralelet në natyrë janë një pasqyrim i bukur i nje orkestrimi madhështor. Një nga këto paralele është fjolla e debores dhe ne. Edhe ne jemi të gjithë në të njëjtin drejtim. Ne shtyhem nga një forcë universale drejt të njëjtit destinacion. Ne jemi të gjithë individë që bëjmë udhëtime të ndryshme dhe gjatë udhëtimit tonë, ndonjëherë përplasemi me njëri-tjetrin, kryqëzojmë udhët, ndryshojmë marrim forma të ndryshme. Por në çdo kohë edhe ne jemi 100% përsosmërisht të papërsosur. Në çdo moment të caktuar ne jemi absolutisht të përsosur për atë që kërkohet për udhëtimin tonë. Por, unë nuk jam perfekt për udhëtimin tënd dhe ti nuk je perfekt për udhëtimin tim. Unë jam i përsosur për udhëtimin tim dhe ti je i përsosur për udhëtimin tënd. Ne po shkojmë në të njëjtin vend, nepermjet rrugëve të ndryshme, por të dy jemi saktësisht të përsosur ashtu siç jemi.

Mendo se çfarë do të thotë të kuptuarit e këtij orkestrimi të madh për marrëdhëniet tona. Imagjino të ndërveprosh me të tjerët duke e ditur se edhe ata e ndajnë këtë paralele me fjollën e borës. Ashtu si ti, ata janë nisur drejt të njëjtit vend dhe pavarësisht se si mund t'ju duken, ata kanë marrë formën e përsosur për udhëtimin e tyre. Sa të forta do të ishin marrëdhëniet tona nëse do të shihnim dhe respektonim se të gjithë jemi të përsosur për udhëtimin tonë."



Karikaturë nga Arben Mexsi

